REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 296 Akti** **Nr. 257 Vendimi**

**Tiranë, më 12.06. 2020**

# V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

| | |
|---|---|
| **Pamela Qirko** | **Kryesuese** |
| **Firdes Shuli** | **Relatore** |
| **Olsi Komici** | **Anëtar** |

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier, në datat 9.6.2020 dhe 12.6.2020, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Miranda Andoni,** me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastër;

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH, E** të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

**Ligji nr. 84/2016,** "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë";

**Ligji nr. 44/2015**, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë";

**Ligji nr. 49/2012,** "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

## TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Firdes Shuli, mori në shqyrtim çdo provë dhe dokument të vënë në dispozicion nga organet kompetente ligjore, shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin Miranda Andoni, e cila në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

## I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

**1**. Znj. Miranda Andoni është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të saj si gjyqtare në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (në vijim, ligji nr. 84/2016).

**2**. Znj. Miranda Andoni, bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe në rregulloren "Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit" i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.3.2019, nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Olsi Komici dhe Firdes Shuli. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes Shuli.

**3**. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim, ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33, të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim, DSIK), sipas neneve 34 - 39, të ligjit nr. 84/2016; dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë, (në vijim, KLD), sipas neneve 40 - 44, të ligjit nr. 84/2016.

**4**. Me shkresën nr. *** prot., datë 5.6.2018, protokolluar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit me nr. *** prot., datë 8.6.2018, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, (në vijim, ILDKPKI) ka vënë në dispozicion aktin përfundimtar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Miranda Andoni.

**5**. Me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 18.2.2020, DSIK-ja ka vënë në dispozicion raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, i deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. ***, datë 6.2.2020.

**6**. Me shkresën nr. *** prot., datë 27.11.2018, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 7.12.2018, KLD-ja ka vënë në dispozicion raportin e analizimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Miranda Andoni.

**7**. Me vendimin nr. 1, datë 26.3.2019, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Miranda Andoni, duke u bazuar në të tri kriteret, si dhe të caktojë kryesuesen e trupit gjykues, komisioneren Pamela Qirko. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

**8**. Në datën 17.4.2019, subjektit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije edhe e drejta për t'u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti nuk u shpreh mbi gjendje konflikti interesi me ndonjë prej anëtarëve të trupit.

**9**. Me vendimin nr. 2, datë 3.3.2020, trupi gjykues vendosi mbylljen e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, dhe vendimmarrja në përfundim të procesit të rivlerësimit, të bazohet në tri kritere: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi profesional, sipas parashikimit të pikës 1, nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

**10**. Në datën 3.3.2020, përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të kundërtën, jo më vonë se data 10.3.2020; (iii) njohjen me provat e

administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40, të Kodit të Procedurave Administrative.

**11**. Në datën 10.3.2020, subjekti rivlerësimit, përmes postës elektronike, dërgoi shpjegimet dhe provat e saj në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ kryesisht.

**12**. Në datën 11.3.2020, trupi gjykues, pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, njoftoi subjektin me anë të postës elektronike mbi zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 13.3.2020, ora 10:00.

**13**. Në datën 11.3.2020, në adresën elektronike zyrtare të Komisionit është administruar një denoncim nga shtetasi H. Q. M., në të cilin ngrihen pretendime për konflikt interesi të relatores së çështjes, znj. Firdes Shuli me gjyqtaren Miranda Andoni.

**14**. Në datën 12.3.2020, përmes postës elektronike, relatorja e çështjes, znj. Firdes Shuli, ka njoftuar anëtarët e trupit gjykues, komisionerët Pamela Qirko dhe Olsi Komici, kryetaren e Komisionit, znj. Genta Tafa (Bungo), si dhe përfaqësuesin e ONM-së, z. Ferdinando Buatier, mbi dorëheqjen e saj nga procesi i rivlerësimit të subjektit Miranda Andoni.

**15**. Trupi gjykues, i zgjedhur me short sipas vendimit të Komisionit nr. 23, datë 10.4.2020, vendosi: (i) mospranimin e kërkesës së bërë nga komisionere Firdes Shuli, për heqje dorë nga shqyrtimi i mëtejshëm i dosjes së subjektit të rivlerësimit, znj. Miranda Andoni; (ii) njoftimin e vendimit komisioneres që deklaroi konfliktin e interesit, kryetares së Komisionit, trupit gjykues dhe vëzhguesit ndërkombëtar.

**16**. Në datën 12.3.2020, trupi gjykues, për shkak të situatës së krijuar në vend nga pandemia *Covid-19*, duke iu referuar kritereve të ushtrimit të aktiviteteve bazuar në urdhrin nr. 156, datë 10.3.2011, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, njoftoi subjektin me anë të postës elektronike për moszhvillimin e seancës dëgjimore të parashikuar për t'u mbajtur në datën 13.3.2020.

**17**. Në datën 2.6.2020, referuar protokolleve për mbrojtjen nga pandemia *Covid-19*, sipas aktit normativ nr. 20, datë 20.5.2020, për disa ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga *Covid-19*, të ndryshuar", trupi gjykues me anë të postës elektronike vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, në seancë dëgjimore në datën 9.6.2020, ora 11:00.

## II. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI

## A. VLERËSIMI I PASURISË

### A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

Subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, me numër indeksi *** dhe ka dorëzuar deklaratat e interesave private ndër vite, për periudhën 2003 – 2017. Në datën 19.1.2017, subjekti ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në bazë të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" .

ILDKPKI-ja ka kryer kontroll të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të, sipas neneve 30-33, të ligjit nr. 84/2016 dhe me aktin nr. *** prot., datë 5.6.2018, ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*

- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

**A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

Megjithëse sipas kreut IV, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjekteve të rivlerësimit, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017 dhe kreut VII, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizoi një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi të kriterit pasuror për subjektin e rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, i cili nuk është bazuar dhe as është detyruar nga përfundimet e paraqitura nga ILDKPKI-ja.

Në përmbushje të funksioneve të tij kushtetuese, Komisioni ka kryer një proces të plotë hetimi administrativ për pasurinë e subjektit Miranda Andoni dhe personave të lidhur me të, sipas dispozitave ligjore të kreut VII, të ligjit nr. 84/2016, bazuar në: (i) deklarimet e subjektit në ILDKPKI; (ii) provat shkresore të administruara nga ky institucion dhe raporti i dorëzuar në Komision; (iii) çdo dokument ligjor që përbën mjet prove ligjore të kërkuar nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit, sipas nenit 49, të ligjit nr. 84/2016; si dhe (iv) komunikimet me subjektin sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016 dhe dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative.

Hetimi administrativ në lidhje me rivlerësimin e pasurisë konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin e deklarimeve të rreme; si dhe (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim verifikimin e deklarimeve të pamjaftueshme në lidhje me kriterin pasuror, sipas parashikimit të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

Hetimi administrativ sipas neneve 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, është kryer në lidhje me:

**Pasuri të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën "Vetting", si vijojnë:**

**1**. **Apartament banimi, me sip. 92.8 m$^2$,** në bashkëpronësi me anëtarët e familjes prindërore me adresë: Rr. "***", p. ***, shk. ***, ap. ***, Përmet. Burimi i krijimit: nga procesi i privatizimit të banesave, viti 1993. Vlera: 12.450 lekë. Pjesa takuese: 20 %.

Në lidhje me këtë pasuri, gjatë hetimit administrativ, ka rezultuar se:

- ASHK-ja Përmet[1] konfirmoi të regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve: M. G. S., G. S., T. S., R. S. dhe S. S. pasurinë me nr. ***, të llojit apartament me sip. 92.8 m$^2$, në Përmet.

- OSHEE-ja[2] informoi se znj. Miranda Andoni (S.) nuk ka lidhur kontratë furnizimi me energji me OSHEE-në, duke konfirmuar se znj. T. S., nëna e subjektit, ka lidhur kontratë të furnizimit nr. ***, në instancën Gjirokastër, që referuar detajeve të klientit, ndodhet në Përmet.

**1.1** Në lidhje me origjinën dhe mënyrën e krijimit të pasurisë nga aktet[3] në dosje rezultoi se:

- me kontratën për privatizimin e banesës së datës 30.8.1993, shtetasi G. S., babai i subjektit, në cilësinë e qiramarrësit, ka privatizuar banesën nr. ***, p. ***, shk. ***, në shumën 12 450 lekë, Përmet;

---

[1] Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. ***prot., datë 11.11.2019, nga ASHK-ja Përmet, në dosjen e Komisionit.
[2] Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 29.10.2019, nga OSHEE-ja, në dosjen e Komisionit.
[3] Shihni aktet në Aneksin 4/2, në dosjen e ILDKPKI-së.

- kjo pasuri është e regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve G. S., M. S., R. S., S. S. dhe T. S., sipas kartelës së pasurisë së paluajtshme si apartament me sip. 92.8 $m^2$, nr. pasurie ***, z.k. ***, në Përmet.

**1.2** Në lidhje me deklarimet e kësaj pasurie, rezultoi se:

- në deklarimin për vitin 2003, subjekti ka deklaruar: *"Apartament banimi 2+1, me sip. 92.8 $m^2$, në qytetin e Përmetit, pjesa takuese 1/5, nr. ***, nga privatizimi";*

- në deklaratën "Vetting", si në pikën 1 më sipër.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit nuk u konstatuan problematika dhe dyshime në lidhje me këtë pasuri. Nisur nga vlera e ulët e çmimit të blerjes për shkak të procesit të privatizimit, kjo pasuri është konsideruar e blerë me të ardhura të ligjshme.

**2. Apartament banimi me sip. 123.5 $m^2$**, në adresën: Rr. "***", ***, Tiranë, blerë me kontratë shitjeje nr. ***, datë 18.6.2008, në vlerën 105.600 euro, me pjesë takuese 50 %. Burimi i krijimit: kredi dhe kursimet familjare ndër vite, nga pagat familjare.

Gjatë hetimit administrativ, në lidhje me këtë pasuri, ka rezultuar se:

- ASHK-ja Tirana Rurale 1[4] konfirmoi të regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve Miranda Andoni (S.) dhe A. A., pasurinë nr. ***, z.k. ***, vol. ***, f. ***, e llojit apartament me sip. 123.5 $m^2$.

- OSHEE-ja[5] konfirmoi kontratë furnizimi me energji nr. ***, në emër të shtetasit A. A., bashkëshorti i subjektit, në instancën e Tiranës, ku nga detajet e klientit konsumatori është me vendndodhje pranë ***, matësi i instaluar në datën 17.4.2008.

**2.1** Në lidhje me mënyrën e fitimit të pronësisë dhe likuidimin e çmimit të blerjes së pasurisë, nga aktet[6] në dosje, rezultoi se:

- sipas certifikatës për vërtetim pronësie të lëshuar në datën 30.6.2007, pasuria e llojit apartament me sip. 123.5 $m^2$, me nr. pasurie ***, e ndodhur në ***, Tiranë, rezulton e regjistruar në emër të shoqërisë "***" sh.p.k;

- me kontratë shitjeje nr. ***, datë 18.6.2008, blerësit A. dhe Miranda Andoni kanë blerë nga shoqëria "***" sh.p.k., pasurinë me nr. ***, në vlerën 105.600 euro;

- me vërtetim pronësie lëshuar në datën 21.6.2008, pasuria me nr. ***, rezulton e regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve A. dhe Miranda Andoni.

Në lidhje me likuidimin e çmimit të shitjes, kontrata e shitjes nr. ***, datë 18.6.2008, parashikon se:

i) është likuiduar shuma prej 25.600 euro jashtë zyrës noteriale, verifikuar me aktin transfertë në llogari, të "Tirana Bank", nga ku rezulton se në datën 12.6.2008, pra, gjashtë ditë para lidhjes së kontratës, bashkëshorti i subjektit, z. A. A., ka trasferuar në llogari të shoqërisë "***" sh.p.k., shumën prej 38.600 euro, me përshkrimin "likuidim pjesor për pasurinë nr. ***, për '***' sh.p.k. (kjo shumë përbëhet nga 25.600 euro paguar për apartamentin dhe13.000 euro paguar për garazhin, për të cilin është redaktuar nje kontratë tjetër shitjeje, trajtuar në vijim);

ii) shuma prej 80.000 euro, do të likuidohet me kredi bankare. Pas verifikimeve u konstatua se sipas aktit bankar "nxjerrje llogarie" për z. A. A., lëshuar nga "Tirana Bank", rezulton se në datën 3.7.2008 është *disbursuar* kredia në shumën 80.000 euro dhe në po këtë datë, kjo shumë

[4]Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 22.4.2019, nga ASHK-ja Tirana Rurale 1, në dosjen e Komisionit.
[5] Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 29.10.2019, nga OSHEE- ja, në dosjen e Komisionit.
[6] Shihni aktet në Aneksin 4/3, në dosjen e ILDKPKI-së.

është transferuar për shoqërinë “***” sh.p.k, me përshkrimin “likuidim përfundimtar për apartamentin ***, sipas kontratës për “***”.

Siç vërehet, regjistrimi i pasurisë në regjistrin e pasurive të paluajtshme është bërë në datën 21.6.2008, pa u likuiduar tërësisht çmimi i shitjes, pasi likuidimi total është kryer me lëvrimin e kredisë, në datën 3.7.2008, pra, rreth trembëdhjetë ditë më vonë. Në këto kushte, dhe në konsideratë të neneve 192,193 dhe 705 e 706 të Kodit Civil, të cilat parashikojnë mënyrën e regjistrimit të pronësisë së sendeve të paluajtshme, si dhe kushtet e vlefshmërisë së kontratës së shitjes, subjekti u pyet mbi rrethanat e regjistrimit të pasurisë pa u likuiduar tërësisht çmimi i saj, i cili në përgjigjet e pyetësorit nr. 3 sqaroi se: *“... regjistrimi i kësaj pasurie në ZVRPP-në Tiranë është kryer në bazë të kontratës së shitblerjes me palën shitëse, e cila ishte dakord për kalimin e pronësisë, pavarësisht se nuk ishte paguar vlera e plotë e sendit. Kjo ishte e vetmja mënyrë për vendosjen e kësaj pasurie të paluajtshme si garanci pasurore në emrin e saj dhe bashkëshortit, për marrjen e kredisë, në masën e pjesës së mbetur të papaguar nga çmimi i plotë i sendit të paluajtshëm. Kjo është një praktikë e njohur nga bankat (neni 563 i KC), dhe aplikohet me qëllim që bleresi i pasurisë me kredi të jetë në të njëjtën kohë edhe garantues i kredisë me pasurinë objekt kredidhënie*”.

Në lidhje me këtë konstatim, në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni vlerësoi se pagimi i shumës së marrë me kredi prej 80.000 euro, në datën 3.7.2008, pra, disa ditë më vonë nga data e rregjistrimit të pasurisë, nuk ka sjellë asnjë pasojë, dhe se subjekti nuk ka kryer ndonjë shkelje ligjore, referuar fakteve: (i) kontrata e shitjes parashikon se *shuma 80.000 euro do të likuidohet me kredi bankare,* pra, palët janë dakordësuar me vullnet te lirë për pagesën e kesaj shume, pas levrimit te kredise; (ii) pagesa u vërtetua të jetë kryer në rrugë bankare në favor të palës porositëse ditën e *disbursimit* të kredisë, datë 3.7.2008; (iii) nga verifikimet e kryera[7] u vërtetua se kjo pasuri është regjistruar në ZVRPP-në Tiranë, sipas procedurave ligjore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme me shënimin “*ka bllokim në seksionin ‘E’ të saj nga ‘Tirana Bank*”.

Veç sa më sipër, në lidhje me këtë pasuri, edhe pse nuk ka pasur të dhëna për një trajtim të mundshëm preferencial të subjektit të rivlerësimit për shkak të detyrës, gjatë hetimit administrativ u kryen verifikime të çmimeve referencë të çmimit të tregut sipas Udhëzimit nr. 1, datë 20.8.2008, të Këshillit të Ministrave. Referuar kësaj VKM-je, çmimi për m/2 ka qenë 100.000 lekë. Sipas këtij çmimi, pasuria apartament me sip. 123.5 $m^2$ në Tiranë do të kushtonte 12.350.000 lekë. Ndërkohë, pasuria është blerë me çmimin 105.600 euro ose 13.008.072 lekë, pra, pak më shtrenjtë se çmimi referencë.

**2.2** Në lidhje me burimin e deklaruar të krijimit të pasurisë: (1) kredi për blerje banese; (2) kursimet familjare ndër vite, nga pagat familjare, nga Komisioni u kryen verifikimet, si vijojnë:

**2.2.1** Në lidhje me kredinë, nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ[8] rezultoi se:

- me “kontratë kredie bankare për shtëpi” nr. ***, datë 2.7.2008, kredimarrësit A. dhe Miranda Andoni kanë marrë nga “Tirana Bank” kredi në shumën 80.000 euro, e cila do të përdorej për blerje apartamenti, me afat 15 vjet. Kjo kredi, ka kaluar direkt nga “Tirana Bank”, në llogari të shoqërisë “***” sh.p.k[9];

- me kontratë hipotekimi nr. ***, datë 2.7.2008, për efekt garancie të kthimit të kredisë së dhënë prej “Tirana Bank”, pasuria nr. ***, apartamenti objekt analizimi në Tiranë në pronësi të shtetasve A. dhe Miranda Andoni është vënë si garanci hipotekore.

[7] Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 5.2.2018, në Aneksin 28 në dosjen e ILDKPKI-së, nga ZVRPP-ja Tiranë.
[8] Shihni aktet në Aneksin 4/8, në dosjen e ILDKPKI-së.
[9] Shkresa nr. *** prot., datë 28.10.2019, nga “Tirana Bank”.

- subjekti ka deklaruar rregullisht dhe sipas ligjit shumat përkatëse të shlyerjes së kredisë, si dhe detyrimet financiare në deklaratat periodike vjetore për periudhën 2008 – 2016.

- në deklaratën "Vetting" subjekti ka deklaruar si detyrim të mbetur shumën 9.632 euro, detyrim ky i konfirmuar nga "Tirana Bank".

**2.2.2** Në lidhje me kursimet familjare ndër vite, me të ardhura nga pagat, nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore dhe dokumenteve zyrtare që vërtetojnë të ardhurat nga pagat e bashkëshortëve Andoni, rezultoi se:

i) në deklaratën periodike vjetore për vitet 2003, 2004, 2005, 2006, dhe 2007, subjekti dhe bashkëshorti kanë deklaruar në fund të çdo viti likuiditete të krijuara me të ardhurat nga pagat, në total prej 3.780.702 lekësh;

ii) për periudhën janar 2008 − qershor 2008, kur është bërë pagesa e këstit të parë, të ardhurat nga pagat kanë qenë në shumën 1.383.800 lekë.

**2.3** Në lidhje me deklarimet e subjektit për këtë pasuri, rezultoi se:

- Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2008, subjekti ka deklaruar: *"Apartament banimi, *** Tiranë, me sip. 123.5 $m^2$, nr. pasurie ***, kontratë shitblerje nr. ***, datë 18.6.2008. Pjesa takuese: 50 %"*. Ndërsa në rubrikën "ndryshime të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme" është deklaruar: *"<u>ndihmë monetare nga nëna T. S. për pagesën e këstit të parë të apartamentit në shumën 3.780 euro</u>; mbyllja e depozitave në parapagimin e këstit të parë të çmimit të apartamentit sipas kontratës së shitblerjes, në vlerën 38.600 euro"*.

- Në deklaratën "Vetting" nuk është deklaruar si burim ndihma monetare në shumën 3.780 euro nga nëna e subjektit, znj. T. S. Pas këtij konstatimi, subjektit iu kërkuan shpjegime nëse shuma prej 3.780 euro i është dhuruar apo dhënë si hua nga nëna e saj.

- Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti sqaroi se shuma prej 3.780 euro është dhënë në formë huaje si ndihmë financiare nga nëna e saj në datën 12.6.2008, pas kërkesës së saj dhe bashkëshortit, për të bërë të mundur pjesën e parapaguar për blerjen e apartamentit në Tiranë.

- Në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, lidhur me shlyerjen e kësaj huaje, subjekti sqaroi se: "*…kjo shumë ende nuk është shlyer dhe se është rënë dakord që ajo do të kthehet pas shlyerjes totale të detyrimit bankar. Mosdeklarimi ka qenë një pakujdesi që ka sjellë si pasojë pasaktësinë e burimit të blerjes, për shkak të ngarkesës gjatë mbledhjes së dokumentacionit për deklaratën 'Vetting', por edhe për shkak se gjatë plotësimit të deklaratës ajo ishte mjaftuar me faktin që pagesa e apartamentit është kryer vetëm nga llogaria e bashkëshortit të saj, pa u thelluar se në atë shumë ishte përfshirë edhe shuma e marrë nga nëna, e cila kishte kaluar në llogarinë e tij shumën prej 3.780 euro*".

Në lidhje me shumën prej 3.780 euro, gjatë hetimit administrativ u vërtetua se kjo shumë: (i) ishte deklaruar në deklaratën periodike vjetore për vitin 2008, si ndihmë financiare nga nëna e subjektit për pagimin e këstit të parë për blerjen e apartamentit dhe garazhit; si dhe (ii) në datën 12.6.2008 (gjashtë ditë përpara lidhjes së kontratës së shitjes), kjo shumë ka kaluar në rrugë bankare nga llogaria e znj. T. (E.) S. në llogari të bashkëshortit të subjektit, z. A. A.. Po këtë ditë, shuma prej 38.600 euro, kësti i parë për blerjen e apartamentit (pjesë përbërëse e të cilës ka qënë dhe shuma prej 3.780 euro), ka kaluar në llogari bankare të shoqërisë porositëse "***" sh.p.k.[10]

Pavarësisht këtyre konstatimeve, në përfundim të hetimit administrativ, subjektit i është kërkuar të japë sqarime në lidhje me konstatimet:

[10] Shihni shkresën nr. ***, datë 28.10.2019, nga "Tirana Bank".

- ka pasaktësi të deklaratave periodike 2008 − 2016 për shkak të mosdeklarimit të detyrimit të pashlyer të kësaj huaje, sipas nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, 'Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar;

- ka pasaktësi të deklaratës "Vetting" për shkak të mosdeklarimit të huas si burim për pagimin e një kësti, si dhe detyrimit financiar ndaj znj. E. S., sipas pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe shtojcës nr. 2, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Në parashtrimet e datës 10.3.2020, si dhe në seancën dëgjimore, subjekti ka vijuar të mbajë të njëjtin qëndrim ashtu sikurse edhe gjatë procesit të rivlerësimit duke deklaruar:

- në lidhje me mosdeklarimin e huas në deklaratën "Vetting": "….*mospasqyrimi i kësaj 'huaje' në deklaratën 'Vetting', ka qenë një pakujdesi gjatë plotësimit të kësaj deklarate për shkak të ngarkesës gjatë mbledhjes së dokumentacionit, duke mos u thelluar në analizën e transaksionit financiar pasi shuma e marrë hua nga nëna T. S., në masën 3.780 euro, nuk ka qenë si veprim financiar më vete…. Mospasqyrimi në deklaratën 'Vetting' nuk ka pasur si qëllim fshehjen e këtij veprimi, i cili është deklaruar menjëherë në deklaratën vjetore për vitin 2008 dhe për më tepër, kjo shumë e marrë nga nëna T. S, zë një masë relativisht shumë të vogël në vlerën totale të transaksionit";*

- në lidhje me mosdeklarimin e detyrimit financiar ndaj znj. E. S.: "… *duke vlerësuar të përmbushur detyrimin (në vitin 2008), sipas pikës 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, nuk kemi deklaruar më pas detyrimin, në kushtet që në vitet e mëpasme duhet të deklaronim vetëm shtesat dhe pakësimet, ndërkohë që nga viti 2008 e deri më sot nuk kemi asnjë ndryshim nuk ka asnjë kthim të kësaj shume".*

**Vlerësimi i Komisionit**

Së pari, lidhur me mosdeklarimin e detyrimit financiar ndaj znj. E. S. në deklaratën për vitin 2008 e në vijim, deri në deklaratën "Vetting", Komisioni vlerësoi të bazuar pretendimin e znj. Miranda Andoni, e cila pranoi pasaktësinë në deklarime duke mosdeklaruar detyrimin financiar në shumën prej 3.780 euro ndaj nënës së saj, për shkak se ka marrë të mirëqenë faktin që kjo shumë ka kaluar në llogari bankare të bashkëshortit si pjesë përbërëse e këstit prej 38.600 euro, dhe për pasojë, dhënien e shumës prej 3.780 euro nga nëna e saj nuk e ka konsideruar si veprim financiar më vete, si dhe, në konsideratë të faktit se nuk ka pasur asnjë ndryshim që nga viti 2008 lidhur me këtë shumë. Nga ana tjetër është e vërtetë që mosdeklarimi i detyrimit financiar ndaj nënës së saj deri në deklaratën "Vetting", mund të çojë në dyshimin se huaja është shlyer nga subjekti në vitet në vijim, por nga analiza financiare, rezultoi se pas vitit 2008, subjekti ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për shlyerjen e huas.

Së dyti, lidhur me mosdeklarimin specifikisht të shumës prej 3.780 euro në deklaratën "Vetting", si një burim për blerjen e pasurisë apartament banimi në Tiranë, sipas parashikimit të pikës 11, nenit 3, të ligjit nr. 84/2016 dhe shtojcës nr. 2 "deklarata e pasurisë" së tij, Komisioni, gjatë procesit të vendimmarrjes vlerësoi se subjekti ka plotësuar në mënyrë të pasaktë deklaratën "Vetting", por e konsideroi këtë pasaktësi të tipit formal që nuk ka sjellë asnjë pasojë, dhe si rrjedhim nuk e gjeti si shkak për penalizim të subjektit, referuar fakteve e provave, si vijojnë: (i) në deklaratën periodike vjetore për vitin 2008, subjekti e ka deklaruar këtë shumë si ndihmë financiare nga nëna e saj për pagesën e këstit të parë për blerjen e pasurisë, sipas dispozitave të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar; (ii) në datën 12.6.2008, shuma prej 3.780 euro, ka kaluar në rrugë bankare nga llogaria e znj. E. S. (e çelur në datën 14.12.2007), në emër të bashkëshortit të subjektit; (iii) shuma prej 3.780 euro është realisht pjesë përbërëse e këstit prej 38.600 euro, paguar prej bashkëshortit të subjektit në llogari të

shoqërisë "***" sh.p.k., po në datën 12.6.2008, si këst i parë i likuidimit të çmimit të blerjes së pasurisë, këst i deklaruar prej subjektit në deklaratën periodike vjetore për vitin 2008 dhe në deklaratën "Vetting"; (iv) veç sa më sipër, gjatë hetimit administrativ, pasi janë kryer hetime edhe në lidhje me ligjshmërinë e të ardhurave të personit të lidhur, nuk pati asnjë të dhënë dhe dyshim që shuma prej 3.780 euro të jetë përfituar në mënyrë të paligjshme nga subjekti i rivlerësimit.

Në përfundim të procesit, bazuar në sa më sipër arsyetuar, subjekti duket se nuk ka pasur asnjë arsye dhe motiv për të fshehur në deklaratën "Vetting" shumën e dhënë nga nëna e saj në vitin 2008, përkundrazi, mungesa e deklarimeve në lidhje me këtë shumë e ka vënë në kushtet e pasaktësisë në deklarim.

Për sa i takon ligjshmërisë së burimeve financiare për krijimin e shumës prej 3.780 euro nga znj. E. S., person tjetër i lidhur sipas pikës 14, nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkua të vërtetojë me dokumente shkresore burimin e ligjshëm të të ardhurave të znj. E. S., sipas parashikimit të pikës 4, nenit 32, të këtij ligji. Në përgjigje të pyetësorëve nr. 2 dhe 3 gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti ka deklaruar se si burim i shumës 3.780 euro së dhënë prej nënës së saj, kanë shërbyer:

Së pari, të ardhurat nga pensioni i znj. E. S., duke vënë në dispozicion vërtetimet nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Gjirokastër[11], nga verifikimi i të cilave rezultoi se të ardhurat e dokumentuara nga pensioni i shtetases T. (E.) S. për periudhën 1992 − 12.6.2008, kanë qenë në shumën 1.184.085 lekë.

Së dyti, ndihmë financiare nga të dy djemtë e saj[12] (vëllezërit e subjektit), emigrantë në shtetin grek, të quajtur R. S. dhe S. S., për të cilët subjekti deklaroi se nëna e tyre ka pasur ndihma financiare deri në vitin 1997. Pas këtij viti, znj. E. S., ka pasur ndihmë financiare vetëm nga vëllai më i vogël, S. S., i cili pas vitit 2011 është kthyer dhe banon me nënën e tyre. Pagesat në shtetin grek kryheshin nëpërmjet dokumentit *'cek banker'* dhe jo nëpërmjet llogarisë bankare".

Për të vërtetuar këto pretendime subjekti ka vënë në dispozicion dokumentet, si vijojnë:

- kopje të dy pasaportave ndërkombëtare të skaduara të vëllait të vogël, z. S. S., me të cilat vërtetohen lëvizjet e këtij shtetasi në Greqi për periudhat 2005 − 2015 dhe 2009 − 2019;

- dokument në gjuhën greke (kartë greke) të shtetasit S. S. në shtetin grek me afat vlefshmërie 2006 − 2015;
- vërtetim të lëshimit të numrit të regjistrit tatimor grek të vitit 2002 për shtetasin S. S., datë 16.8.2002;

- vërtetim regjistrimi të të siguruarit S. S. në shtetin grek, datë 13.4.2004.

Veç sa më sipër, nga verifikimi i të dhënave bankare për personin e lidhur, znj. E. S., u konstatua se depozita e saj me nr. *** euro në "Tirana Bank", prej të cilës në datën 12.6.2008 është transferuar në llogarinë bankare të bashkëshortit të subjektit shuma prej 3780 euro, është çelur në datën 14.12.2007. Në këtë llogari vërehen disa derdhje *cash* prej znj. T. (E.) S. si dhe, në datën 11.6.2008, në këtë llogari janë kryer tri derdhje, përkatësisht në shumat 802 euro, 1.864 euro dhe 1.100 euro.

Pra, depozita në euro në llogari të znj. E. S., e çelur një vit më parë nga dhënia e shumës prej 3.780 euro, është një e dhënë që tregon se kreditimet e kësaj depozite janë kryer me të ardhura

---

[11]Shihni vërtetim nr. ***, datë 31.12.2019, nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Gjirokastër, bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, në dosjen e Komisionit dhe përgjigjet e pyetësorit nr. 3, dërguar nga subjekti me e-*mail* në datën 6.2.2020, në dosjen e Komisionit.
[12]Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 3 dhe dokumentet bashkëngjitur dërguar nga subjekti me e-*mail* në datën 6.2.2020, në dosjen e Komisionit.

të djalit S. S., për të cilin u vërtetua që në këtë periudhë ka jetuar dhe ka punuar në Greqi, referuar dokumenteve të paraqitura nga subjekti, ndërkohë që për vëllain tjetër, z. R. S., pretendimet e subjektit mbeten në nivel deklarativ. Por, duke qenë se nuk u vërtetuan të ardhura të shtetasit S. S., për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, Komisioni nuk e përfshiu kontributin financiar të vëllait të subjektit, z. S. S., në të ardhurat e ligjshme të personit të lidhur, znj. E. S.

Bazuar në sa më sipër, në përfundim të procesit të rivlerësimit, edhe pse nuk u vërtetuan pasuri të tjera në pronësi të personit të lidhur, znj. E. S., përveç pasurisë së përfituar sipas kontratës së datës 30.8.1993, për privatizimin e banesës në Përmet, Komisioni nuk mundi të arrijë në një përfundim nëse të ardhurat e dokumentuara nga pensioni për periudhën 1992 − 12.6.2008 në shumën 1.184.085 lekë, ishin të mjaftueshme për t'i dhënë ndihmën financiare vajzës së saj, shumën prej 3.780 euro, në vitin 2008, si dhe për të përballuar shpenzimet e saj të jetesës. Për këtë arsye, kjo shumë nuk është përfshirë në analizën financiare për vitin 2008, vit në të cilin u ble edhe pasuria apartament banimi në Tiranë.

Së treti, subjekti pretendoi se personi i lidhur, znj. E. S., ka pasur mbështetje financiare edhe nga të afërm të saj, konkretisht, vëllezërit (dajat e subjektit), që jetojnë përkatësisht në SHBA dhe Kanada, si dhe motra (tezja e subjektit) që jeton në Itali, për të cilët pretendimet mbeten në nivel deklarativ, pasi znj. Miranda Andoni nuk ka paraqitur prova shkresore për t'i vërtetuar.

**3**. **Garazh, vendparkim automjeti** (në bashkëpronësi me bashkëshortin A. A.), me sip. 26.9 $m^2$, me adresë: Rr. "***", ***, Tiranë, blerë me kontratë shitjeje nr. ***, datë 18.6.2008, në vlerën 13.000 euro. Pjesa takuese: 50 %. Burimi i krijimit: të ardhura nga kursimet familjare ndër vite, nga pagat, gjendje në llogari bankare në "Tirana Bank".

Në lidhje me këtë pasuri, gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se ASHK-ja Tirana Rurale 1[13], konfirmoi të regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve Miranda Andoni (S.) dhe A. A., pasurinë nr. ***, e llojit garazh me sip. 26.9 $m^2$.

**3.1** Në lidhje me mënyrën e krijimit dhe likuidimin e çmimit të shitjes, nga aktet[14] në dosje, rezultoi se:

- sipas certifikatës për vërtetim pronësie, lëshuar në datën 30.6.2007, pasuria e llojit garazh me sip. 26.9 $m^2$, me nr. pasurie ***, e ndodhur në ***, Tiranë, rezulton e regjistruar në emër të shoqërisë ndërtuese "***" sh.p.k;
- sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 18.6.2008, blerësit A. dhe Miranda Andoni kanë blerë nga shoqëria "***" sh.p.k., pasurinë nr. ***, në çmimin 13.000 euro, likuiduar jashtë zyrës noteriale;

- sipas certifikatës për vërtetim pronësie, lëshuar në datën 21.6.2008, pasuria e llojit garazh, me nr. pasurie *** është e regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve A. dhe Miranda Andoni.

Për sa i takon likuidimit të çmimit të shitjes, gjatë procesit të rivlerësimit, u vërtetua se çmimi prej 13.000 euro, ka kaluar në rrugë bankare nga bashkëshorti i subjektit, z. A. A., te shoqëria "***" sh.p.k., në datën 12.6.2008, vërtetuar nga "Tirana Bank" me shkresën nr. *** prot., datë 28.10.2019 (së bashku me shumën 25.600 euro, paguar si këst i parë për blerjen e apartamentit të sipër analizuar).

Veç sa më sipër, gjatë hetimit administrativ, Komisioni konstatoi se me kontratën e shitjes nr. ***, datë 9.8.2016, shtetasit A. dhe Miranda Andoni ia kanë shitur pasurinë garazh me sip. 26.9 $m^2$ shtetasit B. N., në vlerën 10.000 euro, kontratë në të cilën është parashikuar që çmimi i shitjes do të kalojë te shitësi A. A., nëpërmjet llogarisë së noterit. Kjo kontratë është revokuar

[13]Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 22.4.2019, nga ASHK Tirana Rurale 1, në dosjen e Komisionit.
[14] Shihni aktet në Aneksin 4/4, në dosjen e ILDKPKI-së.

me aktin “revokim kontrate shitjeje nr. ***, datë 9.8.2016”, me nr. ***, datë 8.9.2016, pra, një muaj pas shitjes. Sipas këtij akti, konfirmohet që blerësi nuk ka kryer asnjë pagesë në llogarinë bankare të noterit, me qëllim pagimin e çmimit të shitjes. Kjo kontratë nuk është aplikuar dhe as depozituar nga blerësi në ZVRPP-në Tiranë. Si rrjedhim, pasuria vijon të jetë në pronësi të subjektit dhe të bashkëshortit.

**3.2** Në lidhje me deklarimet e subjektit, rezultoi se:

- Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2008, subjekti ka deklaruar: *“Garazh, në ***, Tiranë, me sip. 26.9 m$^2$, me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 18.6.2008, regjistruar në ZVRPP-në Tiranë me nr. ***, në shumën 13.000 euro. Pjesa takuese: 50 %”.*

Pavarësisht se në këtë deklaratë nuk është përmendur specifikisht burimi i të ardhurave për blerjen e garazhit, subjekti ka përmendur burimin e të ardhurave të kësaj pasurie në deklarimin që ka kryer për apartamentin: “*... mbyllja e depozitave në parapagimin e këstit të parë të çmimit sipas kontratës së shitblerjes, në vlerën 38 600 euro,* <u>shumë në të cilën përfshihet çmimi për blerjen e garazhit prej 13.000 euro</u>*”.* Ky deklarim i subjektit përputhet dhe vërtetohet me: (i) përcaktimet në kontratat e shitblerjeve të apartamentit dhe garazhit datë 18.6.2008, në të cilat specifikohen përkatësisht, shuma 25.600 euro, paguar si këst i parë për blerjen e apartamentit dhe çmimi i paguar për garazhin në vlerën prej 13.000 euro; (ii) transfertën bankare në “Tirana Bank”, në datën 12.6.2008, ku rezulton se në datën 12.6.2008 shtetasi A. A. ka trasferuar në llogari të shoqërisë “***” sh.p.k, shumën prej 38.600 euro.

- Në deklaratën “Vetting”, si në pikën 3 më sipër.

**3.3** Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë garazh, subjekti ka deklaruar si burim krijimi të ardhura nga kursimet familjare ndër vite, nga pagat në “Tirana Bank”, të cilat në total, deri në ditën e blerjes së pasurisë u vërtetuan të jenë në shumën 4.826.226 lekë (3.442.426 lek likuiditete të deklaruara + 1.383.800 lekë nga pagat deri datë 12.6.2008).

**Analizë financiare e pasurive apartament + garazh**

Duke qenë se pagimi i çmimit të garazhit prej 13.000 euro është bërë në të njëjtën ditë me pagimin e këstit të parë për blerjen e apartamentit prej 25.600 euro është kryer analiza financiare për të vlerësuar mbi mundësinë e krijimit me të ardhura të ligjshme të shumës prej 38.600 euro, paguar në rrugë bankare në datën 12.6.2008.

Në përfundim të hetimit administrativ, pasi janë analizuar të ardhurat nga pagat e bashkëshortëve Andoni, likuiditetet e deklaruara prej tyre, pasuritë e blera, si dhe bazuar në shpenzimet e jetesës sipas standardit të ILDKPKI-së, nga analiza financiare, pasqyruar si në tabelën më poshtë, për periudhën deri në datën 12.6.2008, kur është blerë pasuria, rezultoi një balancë negative prej 201.859 lekësh. Në këtë analizë nuk është përfshirë huaja prej 3.780 euro, marrë nga personi i lidhur, znj. E. S., në vitin 2008.

| | **Përshkrimi** | | **12.6.2008** |
|---|---|---|---|
| **1** | **PASURI** | | **1.312.419** |
| | | Apartament banimi ***, kësti i parë 25.600 euro +garazh 13.000 euro = 38.600 euro. | 4.754.845 |
| | | SHTESA/PAKËSIME LIKUIDITETE | -3.442.426 |
| **2** | **TË ARDHURA** | | **1.383.800** |
| | | Të ardhura nga punësimi Miranda Andoni | 559.044 |
| | | Të ardhura nga punësimi A. A. | 824.756 |
| | | Ndihmë monetare nga E. S. për pagesën e këstit të parë 3.780 euro | 0 |
| **3** | **SHPENZIME** | | **273.240** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së | 273.240 |
| | **DIFERENCA (TË ARDHURA -PASURI-SHPENZIME 2-1-3)** | | **-201.859** |

Sipas nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të vërtetuar të kundërtën e këtij konstatimi.

Në parashtrimet e datës 10.3.2020, si dhe në seancën dëgjimore lidhur me analizën financiare, subjekti ka pretenduar se ka dy pasaktësi që lidhen me treguesin "shtesa pakësime likuiditete", si dhe treguesin "të ardhura". Konkretisht:

Së pari, subjekti pretendon se treguesi "shtesa pakësime dhe likuiditete" është realisht në vlerën 3.502.974 lekë, ndërkohë që Komisionit i rezulton në vlerën 3.442.426 lekë. Subjekti nuk e vërtetoi këtë pretendim me ndonjë dokument apo argument, por diferenca e vogël në përllogaritje mund të jetë për shkak të përllogaritjes së kursit të këmbimit të euros.

Së dyti, në lidhje me treguesin "të ardhura", subjekti ka pretenduar se nga Komisioni nuk janë marrë në konsideratë interesat bankare referuar: (i) depozitës në euro në masën 26.000 euro, e *maturuar* në datën 11 qershor 2008 (para blerjes së pasurisë) për shumën 26.890 euro, me interesa në vlerën 890 euro; (ii) depozitës në lekë në shumën 950.000 lekë, e krijuar në prill të vitit 2008, e *maturuar* më 11 qershor 2008 (para blerjes së pasurisë), për shumën 952.319 lekë, nga ku rezulton një fitim prej 2.319 lekësh.

Në lidhje me këtë pretendim, nga verifikimi i dokumenteve bankare, rezultoi se pretendimi i subjektit është i bazuar, pasi sipas informacionit të vënë në dispozicion nga "Tirana Bank"[15] konstatohet se përfitimet nga interesat e depozitave përkatëse janë në vlerën 890 euro (26.890 euro -26.000 euro) dhe 2319 lekë ( 952.319 lekë -950.000 lekë), në total në vlerën 111.951 lekë, shumë e cila nuk ishte përfshirë në analizën financiare. Me përfshirjen e kësaj shume në rubrikën "të ardhura", balanca negative prej 201.859 lekësh, bëhet 89.908 lekë.

Gjithashtu, në parashtrimet e saj, subjekti ka pretenduar që në analizën financiare për periudhën deri në datën 12.6.2008, si e ardhur ligjore duhet të përfshihen edhe të ardhurat nga qiraja e një objekti "Bar-Kafe" në Përmet, të ardhura të cilat në analizën financiare të kryer nga Komisioni me mbylljen e hetimit administrativ nuk ishin marrë në konsideratë.

Në lidhje me këtë pretendim, në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni, pasi analizoi dhe mori në shqyrtim pretendimet e subjektit në parashtrimet e saj, si dhe faktet dhe rrethanat[16], çmoi që të ardhurat nga qiratë për periudhën janar 2008 - qershor 2008, në shumën prej 102.000 lekësh, tatimi për të cilat është paguar gjatë procesit të vlerësimit, datë 6.3.2020, të merren në konsideratë, fakt i cili sjell si pasojë eliminimin edhe të balancës negative të periudhës 1.1.2008 – 31.6.2008, në shumën prej 89.908 lekësh.

**4. Gjendje në llogarinë e pagës së znj. Miranda Andoni,** në shumën 87.976.92 lekë në "Raiffeisen Bank". Pjesa takuese: 100 %, verifikuar të jetë sipas deklarimeve të subjektit me shkresën nr. *** prot., datë 25.10.2019, vënë në dispozicion nga "Raiffeisen Bank".

**5. Autoveturë, e regjistruar në emër të bashkëshortit, z. A. A.,** tip "Mercedes", viti i prodhimit 2006, blerë me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 10.4.2013, në vlerën 700.000 lekë. Pjesa takuese: 50 %. Burimi i krijimit: të ardhura familjare nga pagat dhe nga shitja e një automjeti të mëparshëm.

Gjatë hetimit administrativ, në lidhje me këtë pasuri[17], rezultoi se:

---

[15] Shihni shkresën nr. ***, datë 28.10.2019, në dosjen e Komisionit, nga "Tirana Bank".

[16] Shihni analizën në lidhje me të ardhurat nga qiraja e një objekti në Përmet, në f. 20, pika 3.4, të këtij vendimi.

[17] Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 30.10.2019, në dosjen e Komisionit, nga DPSHTRr-ja.

- DPSHTRr-ja konfirmoi të regjistruar në emër të shtetasit A. A. automjetin me targa *** dhe se ka pasur më parë në pronësi, automjetin me targa ***;

- autovetura tip “Mercedes Benz”, me targa ***, është blerë nga bashkëshorti i subjektit, z. A. A., prej shtetases L. Xh., me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 10.4.2013, në vlerën 700.000 lekë, likuiduar nga blerësi jashtë zyrës noteriale.

**5.1** Nga deklarimet e subjektit në lidhje me këtë pasuri, rezultoi se:

- Në deklarimin për vitin 2013, është deklaruar: *“blerje autoveture me kontratë nr. ***, datë 10.4.2013, në shumën 700.000 lekë. Pjesa takuese: 50 %”.* Nuk është deklaruar burimi i krijimit sipas ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.

- Në deklaratën “Vetting”, si në pikën 5 më sipër.

Subjektit i është kërkuar të japë sqarime në lidhje me konstatimin e mësipërm dhe në parashtrimet e datës 11.3.2020, znj. Miranda Andoni, deklaroi se është e vërtetë që nuk është specifikuar burimi në rubrikën përkatëse, por nga ana tjetër sipas saj, në rubrikën “ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit” rezultojnë të jenë pasqyruar shitja e automjetit që kishin më parë, me targa ***në shumën 4.800 euro dhe më poshtë, blerja e automjetit të ri me targa ***, në shumën 700.000 lekë. Nga verifikimi i deklaratës periodike vjetore për vitin 2013, ky pretendim i subjektit rezultoi të jetë i bazuar.

Në këto kushte, mosdeklarimi i burimit të blerjes së automjetit në rubrikën “përshkrimi ndryshimi i pasurive dhe burimi i krijimit të tyre” në deklaratën periodike vjetore për vitin 2013, nuk është konsideruar nga Komisioni si pamjaftueshmëri në deklarim, referuar edhe faktit se subjekti dhe bashkëshorti kanë pasur të ardhura të ligjshme për blerjen e këtij automjeti.

**5.2** Në lidhje me burimin e krijimit, nga aktet në dosje[18] dhe përgjigjet e pyetësorit nr. 3, rezultoi se si burim për blerjen e këtij automjeti është deklaruar: (1) shitja e një automjeti të mëparshëm; dhe (2) të ardhura nga pagat.

**5.2.1** Për sa i takon të ardhurës së përfituar nga shitja e një automjeti të mëparshëm në shumën 4.800 euro, deklaruar në deklaratën periodike vjetore për vitin 2013, ka rezultuar se me kontratën nr. ***, datë 27.4.2013, z. A. A. ka shitur automjetin tip “Mercedes Benz” me nr. shasie ***, me targa ***, në shumën 4.800 euro, çmim i likuiduar jashtë zyrës noteriale para redaktimit të kontratës.

Siç vërehet, shitja e kësaj autoveture që ka shërbyer si burim për blerjen e automjetit objekt analizimi, është bërë në datën 27.4.2013, pra, 17 ditë pas blerjes së automjetit të ri, në datën 10.4.2013. Lidhur me këtë konstatim subjekti u pyet mbi burimin e saktë të kësaj pasurie, e cila në përgjigje të pyetësorit nr. 2 sqaroi se: “*...burimi i blerjes së automjetit në datën 10.4.2013 është edhe shuma që ne kishim marrë nga shitja e mjetit që kishim në pronësinë tonë edhe pse kontrata e shitjes së këtij mjeti është formalizuar dy javë më vonë nga blerja e automjetit të ri. Ky fakt përmendet edhe në kontratën e datës 27.4.2013, në të cilën, palët kanë pranuar se çmimi i shitjes së mjetit është likuiduar midis palëve jashtë kësaj zyre noteriale dhe përpara redaktimit të kësaj kontrate. D.m.th., shuma e shitjes së mjetit që kishim, ishte marrë në momentin që u krye kontrata e blerjes së mjetit të ri”.*

Pretendimi i subjektit rezulton të jetë i vërtetë, referuar kontratës së shitjes nr. 824/259/2, datë 27.4.2013, e cila parashikon se *çmimi i shitjes së automjetit është likuiduar midis palëve, jashtë kësaj zyre noteriale dhe përpara redaktimit të kësaj kontrate.*

[18] Shihni aktet bashkëngjitur shkresës kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 30.10.2019, nga DPSHTRr-ja, në dosjen e Komisionit

Gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioni verifikoi se autovetura tip “Mercedes Benz” me nr. shasie ***, me targa ***, është blerë nga bashkëshorti i subjektit, z. A. A. me kontratën datë 4.4.2007, në shumën 6.000 euro (në datën 4.4.2007, subjekti ka tërhequr nga llogaria e tij në “Tirana Bank”, shumën prej 630.000 lekësh) me të ardhura të ligjshme, pasqyruar në tabelën më poshtë, si dhe është deklaruar saktësisht në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007.

| | Përshkrimi | | Datë 4.4.2007 | 2007 |
|---|---|---|---|---|
| **1** | **PASURI** | | **199.474** | **1.043.332** |
| | | Autoveturë tip “Benz” *** | | -345.000 |
| | | Autoveturë tip “Mercedes Benz” *** | 725.460 | 725.460 |
| | | SHTESA/PAKËSIME LIKUIDITETE | -525.986 | 662.872 |
| | | Total likuiditete | 2.591.844 | 3.780.702 |
| **2** | **DETYRIME** | | **0** | **0** |
| **3** | **PASURI NETO (1-2)** | | **199.474** | **1.043.332** |
| **4** | **TË ARDHURA** | | **756.967** | **3.181.672** |
| | | Të ardhura nga punësimi Miranda Andoni | 321.235 | 1.179.845 |
| | | Të ardhura nga punësimi A. A. | 381.732 | 1.312.512 |
| | | Të ardhura nga qiraja paguar tatimi burim | 54.000 | 216.000 |
| | | Të ardhura nga shitja automjetit | | 394.095 |
| | | Të ardhura nga interesat bankare | | 79.220 |
| **5** | **SHPENZIME** | | **136.620** | **901.469** |
| | | Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së | 136.620 | 546.480 |
| | | Shpenzime udhëtimi | 0 | 354.989 |
| | **DIFERENCA (TË ARDHURA -PASURI-SHPENZIME 4-3-5)** | | **420.873** | **1.236.872** |

**5.2.2** Për sa i takon të ardhurave nga pagat, gjatë analizës financiare, rezultoi se subjekti ka pasur mjaftueshëm të ardhura nga paga gjatë vitit 2013, për të paguar diferencën prej 26.992 lekësh (700.000 lekë – 4.800 euro ose 673.008 lekë).

Në përfundim të hetimit administrativ nuk ka pasur dyshime dhe problematika në lidhje me automjetin me targa *** në pronësi të bashkëshortit të subjektit, deklaruar në deklaratën “Vetting”, si në pikën 5 të këtij vendimi, si dhe deklarimet e subjektit përputhen plotësisht me dokumentet shkresore të administruara nga Komisioni.

**6. Gjendje në euro në llogarinë bankare në “Tirana Bank” në emër të bashkëshortit, z. A. A.,** që përdoret për ripagimin e kredisë. Pjesa takuese: 50 %. Burimi i krijimit: të ardhurat nga pagat në lekë, *exchange* lekë-euro, në shumën 4.681 euro. Deklarimet, në lidhje me këtë llogari, u verifikuan gjatë procesit të rivlerësimit me shkresën nr. *** prot., datë 28.10.2019 te “Tirana Bank”.

**7. Gjendje në llogarinë bankare të pagës në lekë në “Tirana Bank”** në emër të bashkëshortit, z. A.A., në shumën 57 lekë. Pjesa takuese: 50 %, verifikuar me shkresën nr. *** prot., datë 28.10.2019 te “Tirana Bank”.

**8. Gjendje në llogari kursimi në euro, në “Tirana Bank”** në emër të bashkëshortit, z. A. A., në shumën 243 euro. Pjesa takuese: 50 %. Burimi i krijimit: të ardhura nga dhënia me qira ditore e apartamentit nëpërmjet kompanisë “***” (aplikim *online*), verifikuar me shkresën nr. *** prot., datë 28.10.2019, te “Tirana Bank”.

Duke qenë se gjatë hetimit administrativ nuk u vërtetuan të ardhura nga qiraja si më sipër, shuma prej 243 euro nuk ishte llogaritur si e ardhur ligjore gjatë analizës financiare, të kryer nga Komisioni në përfundim të hetimeve kryesisht.

Pasi është njohur me këtë konstatim në parashtrimet e datës 10.3.2020, subjekti ka deklaruar se kjo shumë është e ardhur si qira ditore, duke vënë në dispozicion "*statement bank*" të periudhës përkatëse "*print screen*" nga faqja e kompanisë "***", që i përkasin prenotimeve *online* te faqja "***", ku duken qartë shumat që kanë kaluar në llogari bankare, në emër të bashkëshortit A. A., si dhe pagesa e tatimeve për këtë të ardhur (të ardhura të realizuara në përudhën tetor-dhjetor 2016, nëpërmjet "***").

Me parashtrimet dhe dokumentet e vëna në dispozicion, e ardhura prej 243 euro, është përfshirë si e ardhur e ligjshme në analizën financiare të vitit 2016.

**Detyrime financiare**

Në rubrikën "detyrime financiare" subjekti ka deklaruar detyrimet, si vijojnë:

**1**. Kredi për blerje apartamenti, bashkëhuamarrëse me bashkëshortin A. A., në "Tirana Bank". Shuma totale e *disbursuar* 80.000 euro, sipas kontratës së kredisë bankare nr. ***, datë 2.7.2008. Interesi: *Index* 3-mujor Euribor+2 %; kësti mujor 131 euro; afati 15 vjet. Data e *maturimit* 3.7.2023. Shuma e detyrimit financiar e mbetur pashlyer 9.632.39 euro.

**1.1** Lidhur me këtë kredi, nga deklarimet ndër vite, rezultoi se:

- Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008 subjekti ka deklaruar "*disbursim kredie nga 'Tirana Bank', kontratë kredie bankare datë 1.7.2008, nr. ***, në shumën 80.000 euro".*

Gjithashtu, është deklaruar shuma e shlyer prej 505.038 lekësh (4.100 euro) dhe gjendja e detyrimit të mbetur në vlerën 9.349.362 lekë (75.900 euro).

- Në deklaratat periodike vjetore për vitet 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016 janë deklaruar saktësisht shumat e shlyera dhe gjendja e detyrimit të mbetur.

Për sa më sipër, subjekti ka qenë i saktë në deklarime, ndërkohë që u krye verifikimi i procedurave ligjore të marrjes së kredisë sipas deklarimeve të subjektit (trajtuar më sipër, f. 6, pika 2.2.1).

**2**. Detyrime për shlyerje kartë krediti, në emër të bashkëshortit A. A., në "Tirana Bank". Shuma e detyrimit të mbetur 304.241 lekë, verifikuar me shkresën nr. ***, datë 4.7.2017, e vënë në dispozicion nga "Tirana Bank".

**Pasuri të deklaruara nga personi i lidhur (bashkëshorti)**

Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. A. A., ka plotësuar autorizimin për kontrollin e deklaratës së interesave, ku ka evidentuar se ka pasuri veçmas të regjistruar në emrin e tij, si më poshtë:

**1**. Apartament banimi, me sip. 83.29 $m^2$, z. k. ***, me adresë: ***, Përmet. Burimi i krijimit: nga procesi i privatizimit të banesave, viti 1993, pjesë e familjes prindërore. Vlera: 2.087.247 lekë. Pjesa takuese: 44 %.

Gjatë hetimit administrativ, në lidhje me këtë pasuri, ka rezultuar se:

- ASHK-ja Përmet[19], konfirmoi të regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve A. A. dhe L. A., pasurinë nr. ***, vol. ***, f. ***, e llojit apartament me sip. 83.29 $m^2$.

[19]Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 11.1.2019, në dosjen e Komisionit.

- OSHEE-ja[20] konfirmoi në emër të z. A. Y. A., kontratë furnizimi me energji me nr. ***, në instancën Gjirokastër, e cila referuar detajeve të klientit ndodhet në Përmet me adresë "***", kategoria "familjar".

**1.2** Në lidhje me origjinën dhe mënyrën e krijimit të pasurisë, nga aktet[21] në dosje, rezultoi se:

- me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 8.6.1993, z. Y. A. (babai i bashkëshortit të subjektit) ka blerë nga Ndërmarrja Komunale e Banesave Përmet, pasurinë: p. ***, ap. ***, në vlerën 27.482 lekë, Përmet;

- sipas certifikatës për vërtetim pronësie, lëshuar në datën 1.11.2012 pasuria e llojit apartament me sip. 83.29 $m^2$, rezulton e regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve A. A., L. A. (nëna e bashkëshortit) dhe L.S. (motra e bashkëshortit).

Gjatë hetimit administrativ nuk u konstatuan problematika dhe dyshime në lidhje me origjinën dhe mënyrën e krijimit të kësaj pasurie. Nisur nga vlera e ulët e çmimit të blerjes për shkak të procesit të privatizimit, kjo pasuri, është konsideruar e blerë me të ardhura të ligjshme.

**Pasuri të deklaruara nga personi i lidhur (e bija)**

Vajza e subjektit të rivlerësimit, E. A., ka plotësuar autorizimin për kontrollin e deklaratës së interesave dhe ka deklaruar si pasuri veçmas të regjistruar në emrin e saj, gjendje në llogarinë e hapur në vitin 2014 në "Deutche Bank" ***, Gjermani për financimin e studimeve dhe mbulimin e kostos së jetesës si student për ushqim, qira, telefon, sigurime shëndeti etj., në shumën 1.685 euro. Pjesa takuese: 100 %.

Burimi i krijimit: (i) transferta: viti 2014, shuma 8.950 euro; viti 2015, shuma 9.300 euro; viti 2016, shuma 2.300 euro. Shumat janë siguruar nga të ardhurat e prindërve dhe nga *maturimi* më 18 gusht 2014 i një depozite bankare e tipit *Junior,* të hapur më 18 shtator 2006 me kursimet ndër vite. Shuma e depozitës së maturuar së bashku me interesat është 4.256 euro; (ii) punësimi *part time* në bibliotekën e universitetit në ***, filluar në mars të vitit 2016. Shuma e përfituar nga punësimi prej muajit mars deri në dhjetor 2016 është 3.257 euro.

Me kërkesë të Komisionit, në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, subjekti vuri në dispozicion historikun (*statement*) e llogarive bankare të vajzës, E. A., të viteve 2014, 2015, 2016, 2017, 2018 dhe 2019, nga verifikimi i të cilave u konstatua se subjekti ka deklaruar saktë në deklaratat periodike të gjitha shpenzimet e kryera, si dhe gjendjet e llogarive bankare në fund të vitit.

Nga analiza financiare rezulton se subjekti dhe bashkëshorti kanë pasur mundësi me të ardhura të ligjshme për krijimin e kësaj llogarie. Gjithashtu, me dokumentin e llogarisë bankare të kreditimit të pagës në "Deutsche Bank" u vërtetuan të ardhura të personit të lidhur, znj. E. A., nga punësimi *part time* në bibliotekën e universitetit ***, sipas deklarimeve të saj.

**Pasuri të deklaruara nga personi i lidhur (i biri)**

Djali i subjektit të rivlerësimit, Y. A., ka plotësuar autorizimin për kontrollin e deklaratës së interesave dhe ka deklaruar pasuri veçmas, të regjistruar në emrin e tij, gjendje në llogari e hapur në shtator të vitit 2016 pranë Stadtsparkasse, Munich, Gjermani, për financimin e shkollës për mësimin e gjuhës dhe studimeve, mbulimin e kostos së jetesës: ushqim, qira, telefon, sigurime shëndeti etj., në shumën 3.273 euro. Pjesa takuese: 100 %.

Burimi i krijimit: transfertë në vitin 2016 e shumës 6.700 euro, siguruar nga: (1) të ardhurat e prindërve; si dhe (2) nga *maturimi* në datën 4.8.2016 i depozitës bankare *Junior,* të hapur më

[20] Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 29.10.2019, nga OSHEE-ja, në dosjen e Komisionit.
[21] Shihni aktet në Aneksin 4/10, në dosjen e ILDKPKI-së.

18.9.2006, me kursimet e prindërve, ndër vite. Shuma e depozitës së *maturuar* së bashku me interesat është 4.299 euro.

Me kërkesë të Komisionit, në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, subjekti vuri në dispozicion historikun (*statement*) e llogarisë bankare të djalit, Y. A., për periudhën 2016 − 2019 nga "Deutsche Bank", nëpërmjet të cilit konfirmohen deklarime të sakta të djalit të subjektit.

Nga analiza financiare rezulton se subjekti dhe bashkëshorti kanë pasur mundësi me të ardhura të ligjshme për krijimin e kësaj llogarie.

**Konstatime të tjera**

Përveç verifikimit të pasurive të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, Komisioni kreu hetime në lidhje me disa konstatime të rezultuara gjatë hetimit administrativ, si vijojnë:

**1.** Konstatime në lidhje me të dhënat bankare

**1.1** Referuar të dhënave bankare të siguruara nga "Tirana Bank"[22] rezultoi se:

i) Në datën 19.6.2006 nëna e bashkëshortit të subjektit, znj. L. A., ka transferuar nga llogaria e saj në "Tirana Bank" në llogarinë e bashkëshortit të subjektit shumën 312.000 lekë. Kjo shumë nuk është deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006 dhe për këtë arsye nuk është përfshirë në analizën financiare të këtij viti, pavarësisht se subjekti ka dhënë shpjegime në lidhje me shkakun e transfertës dhe burimin e të ardhurave të znj. L. A..

ii) Në datën 1.9.2014, znj. L. A.i, ka transferuar nga llogaria e saj në lekë në "Tirana Bank" në llogarinë e vajzës së subjektit, E. A., shumën 716 euro**,** deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike vjetore në vitin 2014.

iii) Në datën 28.7.2016, znj. L. A., ka derdhur në llogarinë e djalit të subjektit të rivlerësimit, Y. A., shumën 599 euro, si ndihmë financiare për studime, deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016.

Edhe pse këto dy transferta bankare të deklaruara nga subjekti në shumat përkatëse prej 716 euro dhe 599 euro nuk e kanë afektuar analizën financiare, pasi gjatë viteve 2014 dhe 2016 subjekti ka rezultuar me balanca pozitive, në zbatim të nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkua të provojë me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të të ardhurave të znj. L. A., e cila është në cilësinë e personit të lidhur, sipas pikës 14, nenit 3, të ligjit nr. 84/2016.

Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti dha sqarime bazuar në dokumente shkresore në lidhje me të ardhura të ligjshme të znj. L. A., buruar prej: (1) depozitë e çelur në emër të saj në "Tirana Bank" në vitin 1998, me gjendje llogarie 650.000 lekë në vitin 2014; si dhe (2) të ardhurat nga pensioni për periudhën 2007 − 2016, në shumën 1.602.092 lekë. Ndërkohë, në lidhje me të ardhurat e bashkëshortit të saj të ndjerë (vjehrri i subjektit), z. Y. A., me profesion mjek në Përmet, subjekti vërtetoi pamundësinë për të vërtetuar të ardhurat me vërtetimin nr. ***, datë 28.1.2020, lëshuar nga njësia vendore e Kujdesit Shëndetësor Përmet, sipas të cilit nuk ka dokumente që vërtetojnë të ardhurat e këtij shtetasi, pasi dokumentet janë dëmtuar gjatë vitit 1997.

**1.2** Si burim për krijimin e shumës prej 599 euro, në vitin 2016 nga znj. L. A., dhuruar nipit të saj.

Duke qenë se znj. L. A. është person i lidhur, gjatë hetimit administrativ janë kryer verifikime pranë institucioneve kompetente ligjore dhe nga përgjigjet e vëna në dispozicion, përveç pasurisë apartament banimi, përfituar nga privatizimi sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë

[22] Shkresa nr. *** prot., datë 28.10.2019, nga "Tirana Bank".

8.6.1993, deklaruar pjesa takuese e pandarë nga bashkëshorti i subjektit në deklaratën "Vetting", nuk u evidentuan pasuri të çdo lloji në emër të saj.[23]

**1.3** Referuar të dhënave të siguruara po nga "Tirana Bank"[24], gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se:

(i) në datën 16.11.2006, shtetasi A. H. ka derdhur në llogarinë e bashkëshortit të subjektit, shumën 15.000 USD dhe po në të njëjtën datë ia ka kthyer përsëri këtë shumë; (ii) në datën 16.11.2006, shtetasi P. S. ka derdhur në llogarinë e bashkëshortit të subjektit shumën 15.000 USD dhe po në të njëjtën datë ia ka kthyer këtë shumë; (iii) në datën 30.7.2010, llogaria e bashkëshortit të subjektit është kredituar në shumën 100.000 lekë me përshkrimin "derdhje nga A. A., likuidim i pjesshëm i detyrimit datë 18.11.2009, derdhur nga V. H.".

Lidhur me këto transkasione, subjektit iu kërkua të japë sqarime mbi shkaqet e tyre si në lidhje me marrëdhënien e saj dhe bashkëshortit të saj me secilin prej këtyre shtetasve, si dhe iu kërkua të japë informacion nëse ka pasur çështje të trajtuara prej saj, ku palë të kenë qenë këta shtetas.

Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti ka sqaruar se në lidhje me shtetasit A. H., P. S. dhe V. H. nuk ka asnjë marrëdhënie shoqërore, familjare, gjinie apo krushqie. Shtetasit me mbiemrin H. i njeh si bashkëqytetarë, me origjinë nga qyteti ku banon, ndërsa shtetasi P. S. është me banim në Lushnjë dhe nuk ka asnjë njohje dhe marrëdhënie me të. Marrëdhëniet me shtetasit A. H., P. S. dhe V. H., kanë të bëjnë vetëm me bashkëshortin e saj si drejtues i degës "Tirana Bank" Përmet, si klientë të kësaj dege banke.

Në lidhje me konfliktin e mundshëm të interesit me këta shtetas gjatë ushtrimit të funksionit të saj si gjyqtare, subjekti deklaroi se nuk ka shqyrtuar çështje ku të kenë qenë pjesëmarrës, pretendime të cilat u vërtetuan me dokumente shkresore zyrtare, të lëshuara nga gjykatat ku ka ushtruar funksionet[25].

Lidhur me transfertat bankare të sipërpërmendura, subjekti ka dhënë sqarime të detajuara për veprimet bankare të këtyre shtetasve me bashkëshortin e subjektit dhe shkaqet e këtyre veprimeve bankare. Në mënyrë të përmbledhur, subjekti ka deklaruar se: "*Në datën 16.11.2006, z. A. H. , klienti i degës 'Tirana Bank', Përmet, kishte kërkuar të tërhiqte cash nga llogaria e tij në USD, për nevoja urgjente, shumën 15.000 USD. Në arkën e degës Përmet nuk kishte gjendje të mjaftueshme cash në monedhën USD, që të mbulonte kërkesën e klientit të z. A. H.. Në vijim të plotësimit të kërkesës për atë klient, u konstatua se në arkën e degës Lushnjë kishte mjaftueshëm gjendje kartmonedha USD për të plotësuar kërkesën e klientit A. H.. Duke qenë se z. P. S. , banues në Lushnjë dhe klient i degës 'Tirana Bank' Përmet, udhëtonte shpesh në Përmet ....., u bisedua me të , nëse ai mund të sillte vetë personalisht në Përmet, shumën USD cash, të kërkuar nga klienti A. H.. Z. P. S. pranoi dhe e mori përsipër veprimin, kështu z. A. H. duhej të kalonte transfertë në llogari të z. P. S. shumën 15.000 USD dhe ky i fundit ta tërhiqte këtë shumë në degën e Lushnjës nga llogaria e vet dhe t'ia kthente më pas këtë shumë z. A. H.. z. A. H. ishte dakord me ketë veprim, por si siguri kërkoi që ndërmjetës të ishte bashkëshorti im si drejtues i degës 'Tirana Bank', Përmet".*

Pretendimet e subjektit u vërtetuan me informacionin e vënë në dispozicion nga "Tirana Bank" me shkresën nr.19164, datë 28.10.2019, nëpërmjet të cilës rezultoi se transkasionet e sipërpërmendura të kryera në llogaritë e bashkëshortit të subjektit dhe shtetasve A. H., P. S., V.

[23]Shihni përgjigjet zyrtare të institucioneve në dosjen e Komisionit.
[24]Shihni shkresën nr. *** prot., datë 28.10.2019, nga "Tirana Bank".
[25]Shihni vërtetimet nga Gjykata e Apelit Gjirokastër, Gjykata e Apelit Vlorë, Gjykata e Apelit Korçë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, në dokumentet bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2.

H., janë kryer brenda ditës dhe se nuk afektojnë në asnjë moment analizën financiare për shkak se nuk kanë shtuar në asnjë rast likuiditetet e subjektit apo të bashkëshortit të saj.

**2.** Nga të dhënat e sistemit *TIMS*

Referuar të dhënave të sistemit *TIMS*, rezulton që subjekti ka udhëtuar jashtë shtetit edhe me automjetet me targa: ***; ***; ***; ***, në lidhje me të cilat në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, sqaroi se: (i) automjeti me targa ***ka qenë në pronësinë e saj dhe të bashkëshortit, me të cilin kanë udhëtuar për qëllime turistike; (ii) automjeti me targa ***është automjeti që kanë në pronësi aktualisht; (iii) automjeti me targa ***është automjeti në pronësi të shtetasit D. B., aktualisht kryetar i Gjykatës së Apelit Gjirokastër, të cilin e ka përdorur për qëllime pune për gjykime në Gjykatën e Apelit Korçë; (iv) automjeti me targa *** është automjet në pronësi të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, ku punon aktualisht, me të cilin ka udhëtuar për arsye pune, deklarime të cilat u vërtetuan pas verifikimit në sistemin AMF.

**3.** Në lidhje me një pasuri objekt lokal shërbimi në Përmet, nga deklarimet e subjektit ndër vite, si dhe aktet në dosje [26], rezultoi se:

**3.1** Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015, subjekti ka deklaruar të ardhura në shumën 5.000 euro, nga shitja e një objekti lokal shërbimi në Përmet, sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 25.8.2014, lidhur midis shtetasit A. A., si shitës dhe shtetasit R. T., si blerës.

**3.2** Lidhur me ligjshmërinë e objektit "Bar-Kafe-Kioskë", Komisioni kreu verifikimet, si vijojnë:

- Subjekti ka deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës, në vitin 2003, se objekti "Bar - Kafe - Kioskë", është ndërtuar mbi truallin me sip. 68 m$^2$, me vlerë 1.500.000 lekë, me burim: (1) kursime familjare; (2) kredi nga BKT-ja në shumën 1.000.000 lekë, shlyer në vitin 1997; dhe (3) të ardhura nga emigracioni i bashkëshortit.

- Nga dokumentacioni që vërteton lejimin e ndërtimit dhe kolaudimin e objektit[27], konstatohet se shpenzimet totale për ndërtimin e këtij objekti, ishin në vlerën 2.000.000 lekë dhe jo 1.500.000 lekë të deklaruara nga subjekti. Pra, subjekti ka deklaruar në mënyrë të pasaktë vlerën e objektit në deklaratën për vitin 2003**.**

Në lidhje me këtë konstatim, subjektit i është kërkuar të japë sqarime pasi u njoh me rezultatet e hetimit kryesisht dhe në parashtrimet e datës 10.3.2020, ka sqaruar se: "*... vlera e shprehur në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003 prej 1.500.000 lekësh është bazuar në aktmarrëveshjen e datës 24.9.1994, nga përmbajtja e së cilës rezulton se vlera e kioskës do të ishte në shumën 18.000 USD, e cila referuar edhe kursit zyrtar të këmbimit të asaj date (84.07 USD/lekë) rezulton në shumën 1,513, 260 lekë".*

Subjekti ka vërtetuar pretendimet e saj me: (i) aktmarrëveshjen e datës 24.9.1994 mes shoqërisë "***" sh.p.k., dhe z. A. A, sipas së cilës shoqëria do t'i sjellë për të shitur z. A.A një kioskë metalike italiane me sip. 30 m$^2$, vlera e të cilës është 18 000 USD; dhe (ii) paraqitjen e kursit të këmbimit për muajin shtator 1994, sipas të cilit 18.000 USD ishin të barasvlefshëm me 1.513.260 lekë.

Për sa më sipër, në përfundim të procesit, Komisioni çmoi se pasaktësia e vlerës së objektit "Bar-Kafe-Kioskë", në deklaratën për vitin 2003, justifikohet me aktmarrëveshjen e datës 24.9.1994, por në analizën financiare të kryer nga Komisioni deri në vitin 2003 (vit në të cilin subjekti ka rezultuar me balancë pozitive), vlera e kioskës është llogaritur sipas

[26]Shihni aktet në Aneksin 4/7, në dosjen e ILDKPKI-së.
[27] Shihni Aneksin nr. 4/7 në dosjen e ILDKPKI-së.

dokumentacionit që vërteton lejimin e ndërtimit dhe kolaudimin e objektit, pra, në vlerën 2.000.000 lekë, dhe jo në vlerën 1.500.000 lekë të deklaruar nga subjekti.

**3.3** Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga shitja e objektit "Bar- Kafe-Kioskë"

Nga verifikimet u konstatua se me shkresën nr. *** prot., datë 18.3.2014 të Bashkisë Përmet[28], shtetasit A. A. i është kërkuar heqja dhe çmontimi i bazës materiale në objektin "Bar-Kafe-Kioskë", dhe në vijim, z. A. A., pasi ka kryer çmontimin, ka shitur pajisjet e luajtshme të objektit "Bar-Kafe-Kioskë", sipas kontratës me nr. ***, datë 25.8.2014, në vlerën prej 5.000 euro, shumë të cilën e kaluar në llogarinë e tij bankare në "Tirana Bank" në datën 29.9.2014 me përshkrimin "të ardhura nga shitja sipas kontratës nr. ***, datë 25.8.2014".

Duke qenë se pajisjet e objektit janë shitur nën vlerën fillestare të shpenzuar për ndërtimin e objektit prej 2.000.000 lekësh, subjekti nuk ka pasur detyrim për të paguar tatim për të ardhurat nga shitja, sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, fakt të cilin subjekti e ka pretenduar duke dhënë argumentet përkatëse në përgjigjet e pyetësorit nr. 2.

**3.4** Lidhur me marrëdhënien e qiradhënies dhe të ardhura të përfituara nga qiratë, nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ[29], rezultoi se :

- me kontratë qiraje (me vërtetim nënshkrimi nr. *** rep.) të datës 29.3.2004, z. A. A. i jep me qira mujore në vlerën 5.000 lekë shtetasit Dh. E. një lokal shërbimi të ndodhur në Përmet, për një afat 2-vjeçar, duke nisur nga data 1.1.2004;

- me deklaratë noteriale nr. ***, datë 17.9.2012 deklaruesit A. A. dhe Dh. E., deklarojnë përsëritjen e kontratës së qirasë së datës 29.3.2004, duke e lënë pa afat, dhe duke ndryshuar qiranë mujore nga 5.000 lekë në muaj, në 20.000 lekë në muaj. Ky ndryshim i çmimit të qirasë ka filluar në datën 1.1.2006 e në vazhdim. Me këtë deklaratë, konfirmohet vijimësia e kontratës së qirasë që nga data 29.3.2004;

- në deklaratat periodike vjetore për vitet 2003, 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013 dhe 2014, subjekti ka deklaruar rregullisht të ardhura nga qira të objektit "Bar-Kafe-Kioskë" Përmet. Me qëllim verifikimin e të ardhurave të përfituara nga qiratë, si të ardhura të ligjshme, nga Komisioni u konstatua se:

**a.** Subjekti ka paraqitur në ILDKPKI dokumente shkresore që vërtetojnë pagimin e tatimit mbi të ardhurat nga qiratë për vitet 2006, 2007, 2010, 2011, 2013 dhe 2014[30]fakt që legjitimon këto të ardhura në shumën totale prej 1.134.000 lekësh (*neto*), pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën më poshtë.

| Përshkrimi | 2006 | 2007 | 2010 | 2011 | 2013 | 2014 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Të ardhura nga qira objekti *bruto* | 240.000 | 240.000 | 240.000 | 240.000 | 240.000 | 60.000 |
| **Të ardhura nga qira objekti *neto*** | **216.000** | **216.000** | **216.000** | **216.000** | **216.000** | **54.000** |
| Pagesë tatim burim | 24.000 | 24.000 | 24.000 | 24.000 | 24.000 | 6.000 |

**b**. Gjatë procesit të rivlerësimit, në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, subjekti ka vënë në dispozicion pagesën e tatimit mbi të ardhurat nga qiratë për vitin 2012, në shumën 24.000 lekë, paguar në datën 28.12.2012, fakt që legjitimon të ardhurat (*neto*) nga qiratë për këtë vit në shumën 216.000 lekë.

**c**. Po kështu, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka vënë në dispozicion tatimin e paguar mbi të ardhurat nga qiratë për vitet 2003, 2004, 2005, 2008, 2009, në datën 6.3.2020, pra, gjatë

[28]Shihni dokumentin në Aneksin nr. 4/7 të ILDKPKI-së.
[29]Shihni Aneksin nr. 4/7 në dosjen e ILDKPKI-së.
[30] Shihni kopje të pagesave të tatimit mbi të ardhurat nga qiraja në Aneksin 4/7, në dosjen e ILDKPKI-së.

procesit të rivlerësimit. Gjatë analizës financiare të kryer, në përfundim të hetimeve paraprake, u konstatua se të ardhurat e përfituara nga qiratë për këto vite afektojnë vetëm analizën financiare për vitet 2003 dhe 2008. Konkretisht, mosmarrja në konsideratë e të ardhurave nga qiratë për vitin 2003 në shumën *neto* 51.000 lekë, sjell si pasojë një balancë negative prej 29.395 lekësh, ndërsa mosmarrja në konsideratë e të ardhurave nga qiratë për vitin 2008, në shumën *neto* prej 204.000 lekësh, sjell si pasojë një balancë negative prej 275.733 lekësh.

Pasi u njoh me këtë konstatim, me marrjen dijeni mbi rezultatet e hetimit, në parashtrimet e saj subjekti deklaroi se: *"Bashkëshorti A. A. nuk ka figuruar debitor si subjekt i tatimit në burim, vërtetuar me printimin nga regjistri elektronik i tatimeve. Edhe nëse do të ishte i tillë, debitor, administrata tatimore referuar neneve 23 dhe 32 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, 'Për procedurat tatimore' duhet të kishte njoftuar në kohë për detyrimet e prapambetura. Ndërkohë edhe nga ana jonë, nuk disponohet dokumentacion që të mund të vërtetojmë pagesën ose mospagesën e tatimit mbi qiranë për vitet e konstatuara. Pavarësisht këtyre fakteve, në kushtet që nuk vërtetohet të kemi kryer pagesën e tatimit mbi qiranë, pasi krijuam edhe gjendjen financiare të nevojshme, për të kryer këtë pagesë të paparashikuar më parë, vendosëm që këto pagesa t'i përfshijmë në deklaratën vjetore individuale të të ardhurave për vitin 2019. Kjo pagesë u krye në këtë mënyrë pasi edhe teknikisht është e pamundur gjenerimi i urdhërpagesave tatimore për këto vite. Tatimi u llogarit dhe u pagua në masën 15 % aq sa është parashikuar nga ligji në momentin e kryerjes së kësaj pagese".*

Për të vërtetuar sa më sipër, subjekti vuri në dispozicion deklaratën vjetore individuale të të ardhurave (DIVA) 2019 të bashkëshortit A. A., me të cilën vërtetohet pagimi i tatimit mbi të ardhurat nga qiratë për vitet 2003, 2004, 2005, 2008, 2009.

Gjatë procesit të vendimmarrjes, duke i çmuar të arsyeshme pretendimet e subjektit në lidhje me pagimin me vonesë të tatimit mbi të ardhurat nga qiratë për vitet 2003, 2004, 2005, 2008 dhe 2009, Komisioni i konsideroi të ardhurat nga qiratë të këtyre viteve, në total, në shumën prej 561.000 lekësh (*neto*) si të ardhura të ligjshme, referuar fakteve dhe provave, si vijojnë: (i) të ardhurat nga qiraja janë deklaruar rregullisht dhe saktësisht nga subjekti në deklaratat periodike vjetore të viteve 2003 − 2016; (ii) marrëdhënia e qiramarrjes është vërtetuar me akte shkresore ndër vite; (iii) subjekti qiramarrës është person fizik i regjistruar në organet tatimore të pajisur me NIPT ***, regjistruar që nga viti 1999; (iv) sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, dhe në referencë të përgjigjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve[31] , duke qenë se qiramarrësi është person fizik, mban në burim (në momentin e pagesës) tatimin mbi qiranë dhe ka detyrimin ta paguajë në organin tatimor. Në përmbushje të këtij detyrimi, qiramarrësi u vërtetua të ketë paguar në kohë reale tatimin mbi të ardhurat nga qiratë për vitet 2006, 2007, 2010, 2011, 2012, 2013 dhe 2014, ndërkohë që për vitet 2003, 2004, 2005, 2008 dhe 2009, nuk e ka paguar tatimin.

**4.** Në deklaratën "Vetting" bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga emigracioni në shumën 1.518.595 lekë, për të cilat, subjekti ka vënë në dispozicion të ILDKPKI-së dokumente shkresore që vërtetojnë këto të ardhura, të cilat subjekti i ka deklaruar edhe në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003, si burim për krijimin e pasurisë "Bar-Kafe-Kioskë'.

Gjatë procesit të rivlerësimit, sipas pikës 3, të nenit D të Kushtetutës, subjektit i është kërkuar të japë sqarime në lidhje me pagimin e detyrimeve tatimore për këto të ardhura, si dhe të bënte përkthimin, noterizimin dhe legalizimin e dokumenteve me vulë apostile, sipas ligjit. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 3 subjekti rikonfirmoi se të ardhurat e bashkëshortit në emigracion i përkasin periudhës korrik 1992 - dhjetor 1993, duke sqaruar se në bazë të kontratës së punës së

[31]Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 14.5.2018, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në dosjen e Komisionit.

nënshkruar midis kompanisë punëdhënëse dhe bashkëshortit datë 27.5.1992, të cilën e ka vënë në dispozicion, ka qenë detyrimi i kompanisë punëdhënëse për të kryer pagesat e tatimit mbi pagën, sigurimet shoqërore shëndetësore etj., detyrime të cilat rezultuan të jenë paguar. Gjithashtu, subjekti paraqiti dokumentet origjinale të përkthyera dhe të noterizuara nga gjuha gjermane në gjuhën shqipe, dokumente sipas të cilave, vërtetohen deklarimet e subjektit në lidhje me: pagat *bruto* të z. A. A. pranë kompanisë "***", ndalesat nga pagat sipas legjislacionit gjerman, si dhe pagat *neto* të tij.

Lidhur me kërkesën për legalizimin me vulë APOSTILE, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se nuk ka mundur të bëjë legalizimin e dokumenteve, duke përshkruar me detaje dhe duke vërtetuar me dokumenta shkresore, hapat që ka ndjekur për të mundësuar përmbushjen e këtij detyrimi, si vijon:

- I është drejtuar me një e-mail konsullatës shqiptare në Munich, duke i kërkuar informacion dhe ndihmë se si duhet të vepronte për apostilimin e dokumentacionit që ai dispononte, prej të cilit, morën përgjigje se për shkak se dokumentacioni ishte lëshuar nga punëdhënës privat apostilimi bëhej i vështirë.
- Në datën 24.1.2020 , kanë dërguar në Gjermani në adresën e vajzës, E. A., gjithë dokumentacionin original me qëllim apostilimin e tyre.
- Në datën 24 janar 2020 vetë vajza E. A. nga ana e saj, i është drejtur zyrës së Apostilave në Landin Bayern, duke kërkuar orientim si duhet të vepronte duke vendosur bashkëlidhur edhe dokumentacionin për të cilin, kërkohej vula apostile.
- Në datën 25 janar 2020, bashkëshorti i është drejtuar me e-mail kompanisë ku ka punuar duke kërkuar prej tyre, një vërtetim për të ardhurat bruto dhe tatimin e paguar.
- Në datën 27 janar 2020 ka ardhur përgjigje nga kompania, ku konfirmohet se nuk disponojnë dokumente për periudhën më përpara se dhjetë vjet.
- Në datën 27 janar 2020 bashkëshorti i është drejtuar me e-mail zyrës së financave të Landit Bayern, duke kërkuar prej tyre vërtetim për të ardhurat dhe tatimet.
- Në datën 29.1.2020, djali Y. A., i cili studion në Berlin, ka udhëtuar vetë në Munich dhe është interesuar drejtpërdrejt për apostilimin e dokumentacionit, por ai nuk ka arritur t'i apostilojë sepse në zyrat që u paraqit e konkretisht në zyrat e financës (Finanzamt) mori përgjigje se ata ruanin të dhëna deri në dhjetë vjet dhe nuk mund t'i vërtetonin këto dokumente dhe për më tepër, janë vlerësuar si dokumente shumë të vjetra dhe të karakterit personal.
- Sipas shërbimit Apostil, në Gjermani, marrë nga www.apostile-service.de., pajisen me vulë apostile dokumentet deri në gjashtë muaj pas datës së lëshimit.

Me gjithë përpjekjet dhe sqarimet e detajuara të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit, në rezultatet e hetimit, subjektit iu la e hapur mundësia për të paraqitur në vijim dokumentet e legalizuara me vulë APOSTILE sipas parashikimeve të Konventës së Hagës, e cila në parashtrimet e datës 10.03.2020, vijoi të deklarojë pamundësinë objektive për të legalizuar dokumentet me vulë APOSTILE, ndërkohë që paraqiti dokumentacionin origjinal që dispon☐nte në lidhje me të ardhurat e bashkëshortit në emigracion.

Në përfundim të procesit, Komisioni krijoi bindjen se, sipas parashikimit të pikës 2, nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, subjekti ka qenë në pamundësi objektive për t'i disponuar dokumentet në formën e kërkuar nga ligji, dhe se mosparaqitja e tyre ka ardhur për shkaqe të arsyeshme, referuar fakteve dhe rrethanave, si vijojnë: (i) përgjigjen e kompanisë "***" ku konfirmohet se kjo kompani nuk disponon dokumente për periudhën më përpara se dhjetë vjet; (ii) përgjigjen e konsullatës shqiptare në Mynih; (iii) informacionin e marrë nga shërbimi Apostil në Gjermani në faqen www.apostille-service.de; (iv) dokumentet origjinale të përkthyera në gjuhën shqipe dhe të noterizuara sipas ligjit, të cilat vërtetojnë të ardhura të ligjshme të bashkëshortit të subjektit për periudhën e hershme korrik 1992-dhjetor 1993; si dhe (iv) përpjekjet dhe

gatishmërinë e subjektit të rivlerësimit për të përmbushur detyrimin ligjor të legalizimit të tyre me vulë apostile, deri ditën e seancës dëgjimore.

**5**. Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2007 subjekti ka deklaruar shitjen e një automjeti tip "Mercedes-Benz" me targa *** dhe nr. shasie ***, në shumën 6.000 euro, blerë me kontratën e shitjes nr. ***, datë 5.6.2007.

Gjatë hetimit administrativ u kryen hetime lidhur me origjinën e këtij automjeti, përfitimin e pronësisë, si dhe ligjshmërinë e të ardhurave të përfituara nga shitja e këtij automjeti, si vijon :

Automjeti me targa *** (ish-automjeti me targa të huaja ***) dhe nr. shasie ***, është blerë nga bashkëshorti i subjektit, z. A. A. me kontratën e shitjes nr. ***, date 1.2.2004, në shumën 190.000 lekë + 148.806 lekë për zhdoganimin dhe është deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike vjetore për vitin 2004. Në total, së bashku me shpenzime të tjera të regjistrimit të automjetit është paguar shuma prej 345.000 lekësh. Për sa i takon mundësisë financiare për blerjen e këtij automjeti në datën 1.2.2004, nga analiza financiare për vitin 2003, vit në të cilin subjekti ka deklaruar gjendjen *cash* shumën prej 720.000 lekësh, të justifikuar me të ardhura të ligjshme, Komisioni arriti në përfundimin se blerja e këtij automjeti është kryer me të ardhura të ligjshme.

Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga shitja e këtij automjeti në vlerën prej 6.000 euro, me kontratë të datës 5.6.2007, gjatë procesit të rivlerësimit subjekti u pyet për pagesën sipas ligjit të tatimit mbi të ardhurat nga shitja dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 3, znj. Miranda Andoni ka deklaruar se në vitin 2007 nuk është paguar tatim mbi të ardhurat nga shitja e automjetit sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", duke dhënë shpjegimet përkatëse. Për këtë arsye, gjatë analizës financiare për vitin 2007, vit në të cilin subjekti ka rezultuar me balancë pozitive, si e ardhur ligjore nuk është konsideruar shuma prej 6.000 euro, përfituar nga shitja e automjetit, por vlera e blerjes së tij prej 345.000 lekësh.

**ANALIZË FINANCIARE**

Gjatë hetimit administrativ, me ndihmën e Njësisë Ligjore, është kryer një analizë e hollësishme financiare e pasurive të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, bazuar në gjendjet e likuiditeteve, në të ardhurat e ligjshme, shpenzimet, detyrimet financiare, të deklaruara nga subjekti dhe personat e lidhur, duke i krahasuar me informacionet e marra në rrugë zyrtare nga institucionet kompetente ligjore. Nga kjo analizë, për periudhën e rivlerësimit 2003 – 2016, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën më poshtë, subjekti rezulton me një balancë negative prej 537.362 leke në vitin 2008, për shkak të mosmarrjes në kosideratë si e ardhur e ligjshme të huas prej 3.780 euro dhënë nga nëna e saj gjatë këtij viti, si dhe një balancë negative prej 208.819 lek ne vitin 2010, të cilat në vlerësimin tërësor të çështjes dhe në proporcion me faktet dhe provat e analizuara në këtë vendim, Komisioni nuk i çmoi si shkak për penalizim të subjektit të rivlerësimit.

| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Përshkrimi** | **PASURI** | **DETYRIME** | **PASURI NETO (1-2)** | **TË ARDHURA** | **SHPENZIME** | **DIFERENCA (TË ARDHURA - PASURI-SHPENZIME 4-3-5)** |
| **Deri 2003** | 2.752.640 | 0 | 2.752.640 | 6.162.336 | 3.388.091 | 21.605 |
| **2004** | 833.476 | 0 | 833.476 | 1.609.532 | 375.856 | 400.200 |
| **2005** | 667.419 | 0 | 667.419 | 1.797.842 | 438.228 | 692.195 |
| **2006** | 1.241.935 | 0 | 1.241.935 | 2.413.093 | 438.228 | 732.929 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **2007** | 1.043.332 | 0 | 1.043.332 | 3.181.672 | 901.469 | 1.236.872 |
| **2008** | 11.454.336 | 9.349.675 | 2.104.661 | 3.173.349 | 1.606.050 | -537.362 |
| **2009** | -148.903 | -1.274.172 | 1.125.270 | 2.863.119 | 1.241.121 | 496.728 |
| **2010** | -403.387 | -2.348.804 | 1.945.417 | 3.070.578 | 1.333.981 | -208.819 |
| **2011** | 897.642 | -1.094.645 | 1.992.287 | 3.193.528 | 884.209 | 317.033 |
| **2012** | 151.574 | -1.086.463 | 1.238.036 | 3.147.134 | 1.349.867 | 559.231 |
| **2013** | 50.020 | -1.668.499 | 1.718.519 | 3.050.533 | 1.116.147 | 215.868 |
| **2014** | 474.504 | -1.345.196 | 1.819.700 | 3.833.057 | 1.578.381 | 434.975 |
| **2015** | -219.732 | -187.892 | -31.840 | 2.913.438 | 2.647.637 | 297.640 |
| **2016** | 217.264 | 130.088 | 87.176 | 3.441.114 | 2.884.253 | 469.685 |
| **TOTAL** | **19.012.120** | **474.092** | **18.538.027** | **43.850.325** | **20.183.518** | **5.128.780** |

**Metodologjia e përdorur nga Komisioni gjatë analizës financiare**

a) Gjendjet e likuiditeteve të subjektit dhe personave të lidhur, të nxjerra nga dokumentet bankare të kërkuar nga: "Tirana Bank"[32], "Raiffeisen Bank"[33], "OTP Bank" [34], si dhe gjendjen *cash*[35] të deklaruar nga subjekti.

b) Të ardhurat e ligjshme ku përfshihen: (1) të ardhurat nga pagat e subjektit si gjyqtare[36] në: Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet për vitet 1994 – maj 2005; Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër për vitet qershor 2005 – deri 2016; (2) të ardhurat e bashkëshortit[37]: në vitet 1992-1993 të ardhura nga emigracioni sipas kontratës së punës së nënshkruar midis kompanisë punëdhënëse "***" dhe bashkëshortit të subjektit datë 27.5.1992, të noterizuara nga gjuha gjermane në gjuhën shqipe; të ardhura nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Përmet[38] për vitet 1995-1996; të ardhura si i vetëpunësuar si person fizik për vitet 1998 – 2002, të ardhura nga Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit, si punonjës në vitet 2003-2005; të ardhura si punonjës në "Tirana Bank" sh.a., nëntor 2005 - dhjetor 2016; (3) të ardhura nga punësimi i vajzës[39], E. A., në Gjermani, në vitin 2016 sipas dokumentit të llogarisë bankare të kreditimit të pagës në "Deutsche Bank"; (4) të ardhura nga qiratë e objektit "Bar-Kafe-Kioskë" në Përmet[40]; (5) të ardhura nga shitja e automjetit[41]; (6) të ardhura nga shitja e pajisjeve të "Bar-Kafe-Kioskë", sipas kontratës[42]; (7) të ardhura përfituar nga shitja e një mjeti me kontratën e shitjes nr.1145/247, datë 5.6.2007; (8) të ardhura nga interesat [43] e depozitave bankare sipas konfirmimit të "Tirana Bank"; (9) dhurim nga znj. L. A.[44] për studimin e fëmijëve në Gjermani; (10) detyrimet, ku përfshihen: kredia bankare për shtëpi[45] sipas kontratës së kredisë nr. ***, datë 2.7.2008, në emër të subjektit dhe bashkëshortit, si dhe shlyerjet e saj.

---

[32]Shihni shkresën nr. ***, datë 28.10.2019, nga "Tirana Bank".
[33]Shihni shkresën nr. *** pro., datë 25.10.2019, nga "Raiffeisen Bank".
[34]Shihni shkresën nr. *** datë 31.10.2019, nga "OTP Bank".
[35]Shihni deklarimet periodike të çdo viti në dosjen e ILDKPKI-së.
[36]Shihni vërtetimin për vitet 1994 – 1997, nga DRSSH –ja; vërtetimin për vitet 1997-1999, 2000-2002, 2003-2005, nga GJRRGJP-ja; vërtetimin datë 19.1.2017, për vitet qershor 2005-2016, nga GJAGJ-ja.
[37]Shihni kontratën me "***" dhe dokumentacionin shoqërues në përgjigje të pyetësorit nr. 3 në dosjen e Komisionit dhe 4/11 në dosjen e ILDKPKI-së.
[38]Vërtetim për vitet 1995-1996, nga DSHP-ja; vërtetim për vitet 1998 – 2002, nga ASSHP-ja; vërtetim nr. *** prot., datë 7.10.2016, për vitet 2003-2005 nga SHPFZH-ja; vërtetim për vitet 2005 – 2016, datë 24.1.2017, nga "Tirana Bank".
[39]Shihni dokumentacionin 4/13, në dosjen e ILDKPKI-së.
[40]Shihni kontratën e qirasë datë 29.3.2004, deklaratën noteriale nr. ***, datë 17.9.2012, në 4/7 në dosjen e ILDKP-së dhe pyetësorin nr. 3 në dosjen e Komisionit.
[41]Shihni kontratën shitblerje automjeti nr. ***, datë 27.4.2013, në dosjen e Komisionit.
[42]Shihni kontratën e shitjes nr. ***, datë 25.8.2014, në dosjen e ILDKPKI-së.
[43]Shihni shkresën nr. ***, datë 28.10.2019, në dosjen e Komisionit nga "Tirana Bank".
[44]Shihni shkresën nr. ***, datë 28.10.2019, në dosjen e Komisionit nga "Tirana Bank".
[45]Shihni kontratën e kredisë bankare nr. ***, datë 2.7.2008, në dosjen e ILDKPKI-së.

c) Shpenzimet e jetesës, ku përfshihen: (1) shpenzimet e jetesës, bazuar në shpenzimet mujore për konsum sipas madhësisë së NJEH (anketa e buxhetit të familjes nga INSTAT-i) dhe 90 % e të ardhurave minimale për vitet 1994 − 1999; (2) shpenzimet e udhëtimit, për të cilat janë marrë të dhëna nga sisitemi *TIMS*. Për përllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit janë marrë si bazë shpenzimet e mesatareve të udhëtimeve sipas linjave ajrore, duke filluar nga 180 euro për udhëtim dhe 250 euro për destinacionet linjë tranzit. Ndërsa për shpenzimet e qëndrimit janë llogaritur 50 euro/ditë shpenzim qëndrimi dhe ushqimi; (3) shpenzime arredimi[46] të deklaruara nga subjekti në pyetësorët e dërguar nga Komisioni; (4) shpenzime interesa të kredisë[47] sipas kontratës kredisë bankare; (5) shpenzimet e shkollimit të fëmijëve në Gjermani[48]; (6) shpenzim ISSAT (Institucion privat i arsimit të lartë[49]) të z. A. A.; (7) vlerat e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme bazuar ne kontratat e shitblerjeve të këtyre pasurive.

## B. KONTROLLI I FIGURËS

DSIK-ja me shkresën nr. *** prot., datë 17.2.2020, vuri në dispozicion Raportin e Grupit të Punës, nr. *** prot., datë 2.11.2017 mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Miranda G. Andoni, i deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. ***, datë 6.2.2020, nga ku rezulton se:

- formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016;

- subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara prej saj në deklaratën për kontrollin e figurës;

- nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

Në konkluzion të këtij raporti, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Miranda G. Andoni.

Pavarësisht këtij konstatimi, Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetit të subjektit të rivlerësimit, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese. Nga verifikimet nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, sipas parashikimit në nenin 37 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit DH të Aneksit të Kushtetutës.

Veç sa më sipër, Komisioni ka kërkuar përditësimin e raportit nga DSIK-ja bazuar në informacionet e marra nga organet ligjzbatuese, si dhe rishikimin e raportit në rast evidentimi të elementeve që do të bënin të domosdoshëm ndryshimin e raportit të mëparshëm. DSIK-ja me shkresën nr. *** prot., datë 2.3.2020, vuri në dispozicion raportin e rishikuar nr. *** prot., datë 19.12.2019, i deklasifikuar pjesërisht me vendimin e KDZH-së nr. ***, datë 28.2.2020, në përfundim të të cilit nuk është ndryshuar konstatimi fillestar.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, në analizë të të gjitha fakteve dhe provave të administruara nga Komisioni nuk u konstatuan elemente që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit, parashikuar nga neni DH i Aneksit të Kushtetutës.

---

[46]Shihni përgjigjet e subjektit sipas pyetësorit nr. 2, në dosjen e Komisionit.
[47]Shihni kontratën e kredisë bankare nr. ***, datë 2.7.2018, në dosjen e ILDKPKI-së.
[48]Shihni dokumentet në 4/12 dhe 4/14 në dosjen e ILDKPKI-së, shkresën nr. ***, datë 28.10.2019, nga "Tirana Bank" në dosjen e Komisionit, deklarimet periodike vjetore të subjektit në dosjen e ILDKPKI-së.
[49]Shihni shkresën nr. ***, datë 29.10.2019, nga BKT-ja në dosjen e Komisionit.

## C. VLERËSIMI PROFESIONAL

Në zbatim të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, bazuar në:

Raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 27.11.2018, protokolluar nga Komisioni me nr. ***, datë 7.12.2018, nga ku rezultuan gjetjet si më poshtë:

### Për aftësitë profesionale

*a) Njohuritë ligjore*

Subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret.

Gjatë gjykimit të çështjes, subjekti ka njohuritë bazë mbi parimet e përgjithshme të aksesit në gjykatë, pjesëmarrjes së palëve në gjykim, të drejtën e mbrojtjes dhe kontradiktoritetit.

Megjithatë, subjekti Miranda Andoni nuk përdor rregullisht parimet e përgjithshme të teorisë së të drejtës, ku është konstatuar vetëm një vendim gjyqësor në të cilin është përmendur parimi i interesit më të lartë të fëmijës. Megjithatë edhe në këtë rast, përmendja e këtij parimi ka qenë vetëm njohuri teorike e saj, pasi në tekstin e arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk është konsideruar si shkelje procedurale fakti që Gjykata e Shkallës së Parë nuk ka respektuar nenin 6 të Kodit të Familjes, sipas të cilit fëmija i mitur 12-vjeçar duhej pyetur para gjykatës, në prani të punonjësit psikolog, lidhur me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore. Në vendimet përfundimtare subjekti nuk i referohet jurisprudencës së gjykatave më të larta. Ndër 8 rastet e vëzhguara, në asnjë rast nuk është paraqitur rekurs.

*b) Arsyetimi ligjor*

Subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej saj janë të qarta dhe të kuptueshme, respekton rregullat e drejtshkrimit, por nuk përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe.

Vendimet e ndërmjetme arsyetohen në nivelin minimal prej saj dhe në përgjithësi atyre iu mungon referenca ligjore (shih dosjet 1, 3 dhe 4). Nuk mungojnë edhe rastet, kur gjatë gjykimit subjekti nuk disponon me vendime të ndërmjetme (shih dosjet 2 dhe 3).

Vendimet përfundimtare, subjekti Miranda Andoni, i strukturon sipas elementëve të kërkuar nga ligji procedural, duke ruajtur strukturë të standardizuar. Në pjesën hyrëse të vendimit, subjekti nuk shënon datën e regjistrimit të çështjes në gjykatë, gjeneralitetet e plota të palëve apo aktet e përfaqësimit të tyre (shih 3 dokumentet dhe dosjet 1, 2 dhe 4). Pjesa arsyetuese hartohet prej saj me tekst unik, me paragrafë të panumërtuar. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve, duke përjashtuar një rast që lidhet me të drejtën e fëmijës së mitur për t'u dëgjuar në prani të një eksperti përpara gjykatës (shih dosjen 2).

Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës dhe respektimit të normës ligjore nga gjykatat më të ulëta dhe kur është rasti identifikon cilësimin e gabuar juridik të veprës penale. Dispozitivi i vendimit tregon qartësisht çfarë ka vendosur Gjykata e Apelit, por në dispozitiv mungon disponimi për shpenzimet gjyqësore, si dhe nuk tregohet e drejta dhe afati i rekursit. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

**Për aftësitë organizative**

*a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë*

Subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016 ka kryer detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Apelit Gjirokastër dhe ka deklaruar se i janë caktuar për gjykim gjithsej 719 çështje dhe ka përfunduar 705 çështje, duke mbartur vitin e fundit gjithsej 32 çështje gjyqësore. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna është 97.9 %. Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Apelit për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016 gjyqtarja Miranda Andoni ka përfunduar 712 çështje, nga të cilat 283 çështje penale, 418 çështje civile të përgjithshme dhe 11 çështje civile familjare.

Aneksi 1 i Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, nuk jep standarde minimale për gjyqtarin e Gjykatës së Apelit që nuk është organizuar në seksione. Germat "h" dhe "i" të pikës 3 vendosin standardet minimale prej 150 gjykimesh penale për relator në dhomën penale dhe 200 gjykime çështjesh civile për relator në dhomën civile. Në këto rrethana, nëpërmjet metodës së interpretimit, është nxjerrë si standard numri prej 200 gjykimesh penale dhe civile për gjyqtarin e Gjykatës së Apelit, që nuk është organizuar në seksione, këto rregulla në rastin e gjyqtares Miranda Andoni nënkuptojnë një ngarkesë sasiore prej jo më pak se 600 gjykime çështjesh të tilla për tre vjet. Duke iu referuar të dhënave statistikore të tij, konstatohet se ngarkesa e saj sasiore ka qenë mbi standardin minimal.

Nga analiza e pesë dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtarja Miranda Andoni, në çdo rast, ka qenë brenda afatit standard apo ligjor. Konkretisht, kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 1 muaj e 23 ditë (shih dosjen 1), 2 muaj e 2 ditë (shih dosjen 2), 2 muaj e 7 ditë (shih dosjen 3), 2 muaj e 9 ditë (shih dosjen 4) dhe 16 ditë (shih dosjen 5). Ndërsa në tri dokumentet ligjore të përzgjedhura prej saj, kohëzgjatja e gjykimit nuk mund të përcaktohet, pasi në tekstin e vendimit nuk është shënuar koha e regjistrimit të çështjes gjyqësore në Gjykatën e Apelit (i është kërkuar subjektit të vërtetojë kohëzgjatjen, trajtuar në vijim).

Gjatë periudhës së rivlerësimit konstatohen se tri ankesa të vitit 2016, të verifikuara për zvarritje në përfundim i janë regjistruar për vlerësim profesional dhe etik për shkak të tejkalimit të afatit standard në gjykim (shih të dhënat nga burimet arkivore trajtuar më poshtë).

Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i pesë dosjeve të shortuara, është konstatuar se gjyqtarja Miranda Andoni i ka arsyetuar vendimet gjyqësore në interval kohor nga 2 ditë (shih dosjen 5) deri në 20 ditë (shih dosjen 1); 3 vendime janë arsyetuar jashtë afatit ligjor (shih dosjen nr. 1, nr. 3 dhe nr. 4); ndërsa 2 vendime brenda afatit ligjor (shih dosjet nr. 2 dhe 5). Vendimi që është arsyetuar me vonesën më të lartë prej 20 ditësh ka qenë çështje civile pa palë kundërshtare.

Në analizë të të dhënave të mësipërme konstatohet se subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, ka pasur ngarkesë sasiore mbi standardin minimal. Në rastet e vëzhguara, të përzgjedhura në mënyrë rastësore, subjekti ka respektuar afatet standarde të gjykimit, por në tri raste ankesash është konstatuar tejkalimi i afatit standard. Lidhur me kohën e arsyetimit të vendimeve, në tri raste nga pesë dosje të vëzhguara gjithsej ka tejkaluar afatin ligjor, por tejkalimi i afatit ka qenë disa ditë dhe në asnjë rast përtej afatit të rekursit.

*b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore*

Dosjet e vëzhguara të gjyqtares Miranda Andoni janë vënë në lëvizje pa vonesa prej saj. Megjithatë, subjekti nuk disponon me vendim/urdhër formal për caktimin e seancës së parë dhe nuk kujdeset që aktet e njoftimit të përfshihen rregullisht në dosje.

Në pesë dosjet e vëzhguara u konstatua se gjykimet kanë përfunduar me 1 seancë (shih dosjet nr. 2, 4 dhe 5); me 2 seanca (shih dosja nr. 1) dhe me 4 seanca (shih dosja nr. 3). Ndër 9 seanca gjyqësore të vëzhguara, 6 prej tyre kanë qenë produktive. Pengesë në 3 seanca gjyqësore joproduktive, të cilat i përkasin të njëjtës çështje, ka qenë mungesa e mbrojtësit dhe/ose të pandehurit (shih dosjen nr. 3). Nuk ka pasur asnjë seancë të dështuar për shkak të vetë gjyqtares Miranda Andoni. Në të gjitha rastet janë marrë masat për njoftimin e palëve, ndonëse dokumentimi i njoftimeve në dosje, veçanërisht për seancën e parë, lë për të dëshiruar.

Distancat kohore midis seancave janë të arsyeshme dhe në raport me shkakun për të cilin seanca është shtyrë. Në një çështje penale, në caktimin e dy seancave gjyqësore nuk është respektuar afati ligjor 15-ditor, por një prej këtyre seancave lidhej me lejen vjetore të gjyqtarëve, në muajin gusht (shih dosjen 3).

Në pesë dosje të vëzhguara, të cilat përmbajnë të dhëna për 9 seanca gjyqësore gjithsej, vetëm dy seanca konstatohet se janë dokumentuar të kenë filluar në orarin e planifikuar (shih dosjet 3 dhe 5), në një dosje gjyqësore, ku gjykimi është zhvilluar me dy seanca, në procesverbal nuk është dokumentuar ora e fillimit dhe e përfundimit të seancës (shih dosjen 1). Në dy dosje të tjera ku gjykimi është zhvilluar me një seancë, në dosje mungojnë aktet e caktimit të seancës së parë dhe të njoftimit të palëve dhe rrjedhimisht nuk mund të konkludohet nëse është respektuar ora e planifikuar e seancës (shih dosjet 2 dhe 4). Ndërsa në një dosje, ku gjykimi është zhvilluar me 4 seanca, në fillimin e 3 prej tyre ka pasur 45 minuta deri në 1 orë e 24 minuta vonesë dhe shkaku nuk është relatuar në asnjë rast (shih dosjen 3). Megjithatë, vonesa në fillimin e seancave nuk ka penguar ecurinë e gjykimit. Seancat gjyqësore janë zhvilluar në sallë dhe janë dokumentuar me regjistrim audio. Përjashtim bën vetëm një rast, ku dy seancat gjyqësore nuk janë regjistruar audio për shkak se përdorimi i sistemit audio ka filluar në datën 6.5.2014, pra, pasi kjo çështje ishte përfunduar (shih dosjen 1).

Gjatë gjykimit, gjyqtarja Miranda Andoni identifikon veprimet procedurale që duhen kryer, merr mendimin e palëve për to dhe disponon me vendime të ndërmjetme. Nuk mungojnë edhe rastet, kur gjatë gjykimit nuk disponon me vendime të ndërmjetme (shih dosjet 2 dhe 3). Gjyqtarja Miranda Andoni, përgjithësisht, zhvillon në mënyrë korrekte procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, duke ndjekur hapat që lidhen me çeljen e seancës, verifikimin e palëve me të drejtat dhe detyrimet procedurale, si dhe për prezantimin e gjykatës. Në një rast kur është vendosur gjykimi në mungesë të palëve, gjyqtarja ka ometuar të revokojë këtë vendim të ndërmjetëm, edhe pse një prej palëve është paraqitur me vonesë në gjykim. Në të njëjtën çështje, gjyqtarja Miranda Andoni nuk ka disponuar me vendim formal për kërkesën e mbrojtësit, që lidhej me pyetjen e të miturit në prani të një specialisti psikolog, si dhe nuk ka arsyetuar qartësisht dhe plotësisht për këtë çështje në vendimin përfundimtar (shih dosjen 2).

*c) Aftësia për të administruar dosjet*

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura me short janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Në pesë dosjet e vëzhguara mangësitë janë të njëjta: nuk ka akt formal të gjyqtarit relator për caktimin e seancës së parë gjyqësore, përgjithësisht aktet e njoftimit të palëve mungojnë në dosje apo nuk përfshihet në dosje lista e shpalljeve, nuk ka relacion me shkrim nga relatori i çështjes. Procesverbali gjyqësor plotëson kërkesat e ligjit procedural civil dhe penal. Në tri dosje gjyqësore nuk janë inventarizuar aktet procedurale, megjithatë duhet evidentuar se kopjet e dosjeve janë paraqitur në gjykatë nga gjykatat e rretheve gjyqësore.

**Për etikën dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

*a) Etika në punë*

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit "8 tetor 2013 − 8 tetor 2016", për gjyqtaren Miranda Andoni janë paraqitur gjithsej 9 ankesa në Inspektoratin e KLD-së (1 ankesë në vitin 2013, 1 ankesë në vitin 2014, 4 ankesa në vitin 2015 dhe 3 ankesa në vitin 2016).

Dy ankesa të vitit 2015 janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar me arsyetimin se pretendimet mund të zgjidhen përmes apelimit gjyqësor. 3 ankesa të tjera (1 e vitit 2013, 1 e vitit 2014 dhe 1 e vitit 2015) janë verifikuar për zvarritje gjykimi dhe mosrespektim formal të ligjit, por janë arkivuar pas verifikimit, pasi pretendimet kanë rezultuar të pabazuara.

Një ankesë e vitit 2015 është verifikuar për zvarritje gjykimi dhe moszbatim formal të ligjit, ku pretendimi për zvarritje gjykimi është arkivuar pasi ka rezultuar i pabazuar, ndërsa pretendimi për mosrespektim formal të ligjit është në verifikim në vijim deri në përfundimin e gjykimit të çështjes nga Gjykata e Lartë. Ndërsa 3 ankesa të vitit 2016 janë verifikuar për zvarritje gjykimi dhe në përfundim, i janë regjistruar gjyqtares për vlerësim profesional dhe etik, pasi është konstatuar tejkalim i afateve standard në gjykim (për të tria rastet, subjektit i është kërkuar të japë sqarime gjatë procesit të rivlerësimit, trajtuar si më poshtë).

Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Miranda Andoni përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

*b) Integriteti*

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

*c) Paanësia*

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, znj. Miranda Andoni. Për gjyqtaren Miranda Andoni, në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve. Në një çështje familjare për zgjidhje martese, kanë qenë objekt shqyrtimi edhe të drejtat e fëmijës së mitur 12 vjeç, për të cilin mbrojtësi ka pretenduar se nuk është marrë në pyetje sipas nenit 6 të Kodit të Familjes. Gjyqtarja nuk i ka dhënë përgjigje me vendim të ndërmjetëm gjatë gjykimit kësaj kërkese, ndërsa në vendimin përfundimtar, ndonëse ka përmendur parimin e interesit më të lartë të fëmijës, nuk ka shpjeguar qartësisht mbi këtë çështje (shih dosjen 2).

Në tri dokumentet ligjore dhe katër dosjet e tjera të vëzhguara nuk janë konstatuar çështje të tjera, që lidhen me grupet në nevojë, barazinë gjinore apo të pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorimi i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

**Për aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

*a) Aftësitë e komunikimit*

Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor në format letër, nuk ka të dhëna të plota për mënyrën e komunikimit të subjektit Miranda Andoni me palët ndërgjyqëse. Në të tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

*b) Aftësia për të bashkëpunuar*

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit Miranda Andoni për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Në tri prej pesë dosjeve të vëzhguara është konstatuar se bashkëveprimi me anëtarët e trupit gjykues dhe administratën gjyqësore nuk ka qenë në nivelin e duhur, pasi është konstatuar vonesë në depozitimin e dosjes në sekretarinë gjyqësore (shih dosjen nr. 1, nr. 3 dhe nr. 4).

*c) Gatishmëria për t'u angazhuar*

Subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, pas diplomimit si juriste në vitin 1988, nuk ka kryer ndonjë specializim në ndonjë fushë të së drejtës. Për shkak të funksionit që kryen, i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, subjekti ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 16 seminare me 28 ditë trajnim gjithsej, të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës. Lënda e trajnimeve lidhet me të drejtën penale dhe civile.

**Rivlerësimi nga Komisioni**

Gjatë procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, sipas nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni është bazuar në:

Informacionin e marrë nga burime të ligjshme, konkretisht, informacioni i marrë nga:

**1**. Raporti i KLD-së, dërguar me shkresën nr. 2539/3 prot., datë 27.11.2018, pas analizimit objektiv dhe të pavarur të të cilit, Komisioni evidentoi përgjithësisht të njëjtat mangësi, të cilat iu bënë me dije znj. Miranda Andoni me njohjen e rezultateve të hetimit, duke i kërkuar të japë sqarime. Në parashtrimet e datës 10.3.2020, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti ka dhënë shpjegime në lidhje me konstatimet, si vijon:

Së pari: "*Në lidhje me mungesën vendim/urdhër formal për caktimin e seancës së parë, kam mendimin se kjo mungesë ka lidhje me parashikimet ligjore në Kodin e Procedurës Civile përpara se të hynin në fuqi ndryshimet me ligjin nr. 38/2017, ku në nenin 460 të Kodit të Procedurës Civile, paragrafi i dytë i kësaj dispozite, ishte parashikuar se kryetari i Gjykatës së Apelit cakton relatorin e çështjes dhe ditën e gjykimit. Tashmë kjo dispozitë e ndryshuar parashikon detyrimin e relatorit të çështjes në Gjykatën e Apelit, që të caktojë datën dhe orën e gjykimit.*"

Në analizë të këtij pretendimi, Komisioni vlerësoi se shpjegimet e subjektit janë bindëse, pasi referuar nenit 460/2 të Kodit të Procedurës Civile, para ndryshimeve të vitit 2017, dita e gjykimit caktohej nga kryetari i gjykatës dhe jo nga relatori. Ndërsa me ndryshimet që pësoi Kodi i Procedurës Civile në vitin 2017, sipas nenit 460/2, caktimi i datës së gjykimit bëhet nga relatori i çështjes, ndërkohë që dosjet e analizuara, i përkasin viteve 2013, 2014, 2015 dhe 2016, pra, përpara hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore të vitit 2017.

Së dyti: *"Mungesa në vendimin gjyqësor të datës së regjistrimit të çështjeve, të përbërësve të plotë të gjendjes civile të palëve, të pasqyrimit të së drejtës për rekurs, kanë të bëjnë me vazhdimin e praktikës së gjetur në këtë shkallë gjykimi, por, që tashmë janë tërësisht të korrigjuara. Mungesat e sipërcituara nuk janë kontestuar dhe nuk kanë përbërë shkak për cenim të ndonjë vendimi gjyqësor. Mungesa e pasqyrimit të shpenzimeve gjyqësore ka qenë kryesisht në çështjet kur Gjykata e Apelit vendoste lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë pasi me këtë disponim vlerësohej se vendimi lihej në fuqi edhe për pjesën që kishte lidhje me shpenzimet gjyqësore.*

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, pavarësisht pretendimeve të subjektit, Komisioni evidentoi elementët që duhet të përmbajë një vendim gjyqësor, parashikuar në nenin 310 të Kodit të Procedurës Civile, dhe në nenin 383 të Kodit të Procedurës Penale, ku ndër të tjera përfshihen edhe gjeneralitetet e palëve, shpenzimet gjyqësore apo e drejta e ankimit/rekursit. Po ashtu, përkundër sa pretendohet nga subjekti, shpenzimet gjyqësore nuk janë pasqyruar në dispozitiv jo vetëm në rastet kur është lënë në fuqi vendimi i shkallës së parë (4 nga dosjet me short, 3 çështje penale, 1 civile), por edhe kur vendimi është ndryshuar (shih 3 dokumentet e përzgjedhura nga të cilat dy çështje janë civile dhe një penale dhe dosjen nr.1). Megjithatë, duke qenë se, sipas nenit 383 të Kodit të Procedurës Penale, dhe nenit 119 të Kodit të Procedurës Civile, mungesa e elementëve të tillë në përmbajtje të vendimit nuk sjell si pasojë pavlefshmërinë e tij, Komisioni nuk i çmoi mangësitë e evidentuara, si shkaqe që mund të cënojnë aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

Së treti: *"Në lidhje me arsyetimin e vendimeve, pavarësisht përpjekjeve të mia për t'i arsyetuar në kohë, vonesa për rastet e konstatuara mund të jetë për shkak të ngarkesës në punë".*

Në analizë të këtij pretendimi, në konsideratë të faktit se bëhet fjalë për tri vendime të arsyetuara prej saj jashtë afatit ligjor, ku vonesa më e lartë është 20 ditë, për të vlerësuar ngarkesën në punë të subjektit të rivlerësimit, Komisioni iu referua Aneksit 1 të sistemit të vlerësimit. Ky aneks nuk jep standarde minimale për gjyqtarin e Gjykatës së Apelit e cila nuk është organizuar në seksione, por nëpërmjet metodës së interpretimit nga KLD-ja, është nxjerrë si standard numri prej 200 gjykimesh penale e civile për gjyqtarin e apelit, çka nënkupton një ngarkesë sasiore prej jo më pak se 600 gjykime për subjektin Miranda Andoni. Pra, ky rregull, në raport me 705 çështjet e përfunduara për periudhën e rivlerësimit nga subjekti Miranda Andoni, do të thotë se ngarkesa e saj sasiore ka qenë mbi standardin e vendosur, fakt që vlerësohet si shkak për arsyetimin me vonesë të vendimeve në rastet e konstatuara.

Së katërti: *"Fillimi i gjykimeve, jo në orarin e planifikuar ka ardhur si rrjedhojë e tejkalimit të kohës së planifikuar në gjykimet e mëparshme pasi nuk rezulton që gjykimet të kenë filluar me vonesë për shkaqe subjektive".*

Në analizë të këtij pretendimi, duke mbajtur në konsideratë faktin se bëhet fjalë për çështjen nr. 5 të përzgjedhur me short, ku 3 nga 4 seancat gjyqësore kanë nisur me vonesë, nga 45 minuta - 1 orë e 24 minuta, nga analiza e materialeve te dosjes, vërehet se kjo vonesë në fillimin e seancave nuk ka penguar ecurinë e gjykimit dhe as ka sjellë si pasojë ndonjë pretendim të palëve për shtyrje të kryera me qëllim nga subjekti i rivlerësimit.

Së pesti*: "Në lidhje me gjykimin e nj*ë *çështjeje familjare, pala e paditur ka kërkuar pyetjen e fëmijës, vajzës 12 vjeç, dhe kjo kërkesë ka qenë në kuadrin e riçeljes së hetimit gjyqësor (neni 465 Kodi i Procedur*ës *Civile), por në kushtet që Gjykata e Apelit ka vlerësuar çështjen të sqaruar dhe ka dhënë vendimin përfundimtar duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, për rrjedhojë, kjo kërkesë për pyetjen e fëmijës, është vlerësuar si e panevojshme dhe e pabazuar. Përfundimi i gjykimit në një seancë të vetme ka qenë në funksion të interesit më të lartë të fëmijës. Ky vendim nuk rezulton të jetë rekursuar dhe sipas shënimit nga Gjykata e Shkallës së Parë ka marrë formë të prerë".*

Lidhur me këtë çështje, Komisioni konstatoi se pavarësisht pretendimeve të znj. Miranda Andoni, neni 465 i Kodit të Procedurës Civile parashikon: "*Me kërkesën e palëve ose edhe kryesisht Gjykata e Apelit përsërit tërësisht apo pjesërisht hetimin gjyqësor. Në shqyrtimin gjyqësor mund të lexohen aktet e gjykimit të shkallës së parë. Gjykata ka të drejtë të marrë edhe prova të reja".* Bazuar në këtë dispozitë ligjore vlerësohet se subjekti ka pasur vend për të vendosur çeljen pjesërisht të hetimit gjyqësor. Por, nga verifikimi i akteve në dosje ka rezultuar se në këtë çështje komunikimi i subjektit të rivlerësimit ka qenë korrekt, nuk ka përdorim të

gjuhës diskriminuese, nuk ka pasur ndonjë kërkesë për përjashtim të saj nga gjykimi i çështjeve, si dhe për vendimin në fjalë nuk është ushtruar rekurs. Referuar këtyre fakteve, në përfundim, Komisioni vlerësoi se nuk ka elementë që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit në gjykimin e kësaj çështjeje.

**2**. Tri vendimet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, nga analizimi i të cilave në përfundim të hetimit administrativ, rezultoi se:

**2.1** Për çështjen që i takon vendimit nr. ***, datë 29.4.2014 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër me paditës/kpaditur A. Z. kundër të paditurit/kpaditës K.Z. me objekt "kallëzim i një punimi të ri" me vërtetimin nr. *** prot., datë 11.2.2020, të lëshuar nga Gjykata e Apelit Gjirokastër[50]u vërtetua se çështja është regjistruar në datën 8. 4.2013 dhe ka përfunduar në datën 29.4.2014. Çështja ka pasur si relator fillimisht gjyqtaren M. Q. dhe i ka kaluar elektronikisht gjyqtares Miranda Andoni në datën 9.7.2013, vërtetuar me kopje të regjistrit të veprimeve dhe regjistrit manual. Pas marrjes nga subjekti Miranda Andoni, çështja ka zgjatur 9 muaj e 20 ditë, pra, në tejkalim të afatit 6-mujor të gjykimit civil në Gjykatën e Apelit të parashikuar në vendimin nr. ***, datë 14.4.2010 te KLD-ja "Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve".

Lidhur me këtë konstatim, në parashtrimet e datës 10.3.2020, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti ka dhënë shpjegime duke vënë në dispozicion edhe procesverbalet e seancave gjyqësore[51], duke deklaruar se : "*Nga aktet e dosjes rezulton se jam futur në këtë proces në zëvendësim të gjyqtares M. Q. (emëruar në Gjykatën e Apelit Tiranë), në cilësinë e relatores dhe pasi jam njohur me dosjen kam pranuar që gjykimi të vazhdojë në momentin procedural të mbetur, e pikërisht në kryerjen e ekspertimit. Në rastin në shqyrtim, çështja civile paraqitej komplekse pasi do të shqyrtoheshin njëherësh padia dhe kundërpadia, por edhe për shkak të natyrës së këtyre kërkimeve, pretendimeve dhe prapësimeve të palëve në këtë proces. Pala paditëse kërkonte kallëzimin e një punimi të ri, ndërkohë i padituri kërkonte pushim cenim në pronësi. Për kryerjen e aktit të ekspertimit dhe për t'i kthyer përgjigje gjykatës, ekspertët kanë kërkuar nga gjykata sigurimin e dokumentacionit që ata kanë vlerësuar si të nevojshme për të kryer aktin, kërkuar me kërkesë me shkrim (studim pjesor etj.), kërkesë e cila është pranuar edhe pse pala e paditur nuk ishte dakord. Me administrimin e akteve të reja shkresore gjatë gjykimit në shkallë të dytë është pretenduar në lidhje me vërtetësinë e dokumentacionit të Bashkisë Sarandë, është pretenduar falsiteti i një vendimi të KRT-së së kësaj bashkie dhe në kushte të tilla ka lindur nevoja dhe është kërkuar gjithë praktika dokumentare nga bashkia për dokumentacionin për të dy palët ndërgjyqëse me qëllim hetimin në lidhje me këtë kërkim. Gjatë gjykimit, pati debat në lidhje me dokumentacionin e lëshuar nga Bashkia Sarandë, ku prej palëve është pretenduar se dokumentacioni i ndodhur në dosje nuk ishte i njëjti me dokumentacionin që paraqiste pala paditëse lëshuar nga Bashkia Sarandë. Pati shumë debat në lidhje me vërtetësinë e dokumentacionit të lëshuar nga Bashkia Sarandë dhe është kërkuar nga bashkia çdo dokument që ka qenë i domosdoshëm për të konkluduar në lidhje me pretendimet për vërtetësinë e tyre. Gjatë gjykimit vetëm një seancë gjyqësore nuk është zhvilluar për shkak të mosparaqitjes time për shkaqe shëndetësore (është depozituar raporti mjekësor)*" .

Pasi verifikoi procesverbalet e seancave gjyqësore, në analizë të pretendimeve të subjektit, Komisioni konstatoi se tejkalimi i afateve në gjykimin e çështjes ka ardhur për shkaqe të justifikueshme e të rrethanave, si vijojnë: (i) subjekti ka hyrë në proces tre muaj nga data e regjistrimit të çështjes, duke zëvendësuar gjyqtaren e parë të çështjes, pretendim i vërtetuar me vërtetimin nr. *** prot., datë 11.2.2020, të lëshuar nga kancelari i Gjykatës së Apelit Gjirokastër; (ii) kompleksiteti i çështjes për shkak të shqyrtimit njëherësh të padisë dhe

[50]Shihni dokumentet bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 4, në dosjen e Komisionit.
[51] Shihni procesverbalet e seancave gjyqësore dërguar në rrugë elektronike në datën 4.6.2020, në dosjen e Komisionit.

kundrapadisë (paditësi kërkonte kallëzim punimi të ri, kurse i padituri kërkonte pushim cenim në pronësi); (iii) kërkimet e palëve dhe ekspertëve të thirrur gjatë procesit gjyqësor; (iv) një seancë gjyqësore nuk është zhvilluar për shkak të mosparaqitjes së subjektit për arsye shëndetësore, duke paraqitur raport për paaftësi të përkohshme në punë për 5 ditë.

**2.2** Për çështjen që i takon vendimit nr. ***, datë 19.2.2015, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, që i përket Prokurorisë së Rrethi Gjyqësor Gjirokastër kundër të pandehurit A.N., subjekti ka vënë në dispozicion vërtetimin nr. *** prot., datë 11.2.2020, të lëshuar nga kancelari i Gjykatës së Apelit Gjirokastër[52] sipas të cilit çështja penale është regjistruar në datën 12.3.2014 dhe ka përfunduar në datën 19.2.2015. Pra, vërehet se kohëzgjatja e gjykimit është 11 muaj e 7 ditë, pra, në tejkalim të afatit 6-mujor të parashikuar për gjykimet penale në Gjykatën e Apelit, për krimet që dënohen në maksimum deri në 10 vjet burgim (i pandehuri është gjykuar për veprën penale "vjedhje duke shpërdoruar detyrën" të parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal).

Lidhur me këtë konstatim, në parashtrimet e datës 10.3.2020, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti ka dhënë shpjegime duke vënë në dispozicion edhe procesverbalet e seancave gjyqësore[53], duke deklaruar se: "*Nga përmbajtja e akteve, ndodhur në dosjen gjyqësore rezulton se, shkaqet e kësaj kohëzgjatjeje kanë të bëjnë me kryerjen e hetimit të pjesshëm në këtë shkallë gjykimi, urdhërimi për kryerjen e një ekspertimi kontabël në kushtet që gjatë hetimeve dhe gjykimit në shkallë të parë mungonte të ishte kryer një veprim i tillë i domosdoshëm dhe i kërkuar si nga i pandehuri dhe nga prokurori. Në këtë çështje, Gjykata e Shkallës së Parë kishte konkluduar me një ndryshim të kualifikimit ligjor të veprimeve të të pandehurit, ndërkohë që prej prokurorisë kërkohej pranimi i akuzës së ngritur prej tij ndërsa i pandehuri kërkonte deklarimin e tij të pafajshëm. Fillimisht është kërkuar që ekspertimi të kryhej nga një ekspert i licencuar në fushën e auditit të bankave dhe në kushtet që nga Banka e Shqipërisë ka ardhur përgjigje negative, Gjykata e Apelit ka vendosur që këtë detyrë ta kryejë një ekspert kontabël. Kryerja e seancës së betimit dhe kryerja e aktit të ekspertimit ka kërkuar kohë në kushtet që për të kryer këtë Akt lindi domosdoshmëri, administrimi i gjithë dokumentacionit për periudhën e pretenduar nga banka përkatëse dhe për shkak të volumit ky dokumentacion është dorëzuar një seancë më vonë. Gjithashtu, gjatë gjykimit mbi kërkesën e prokurorit, Gjykata e Apelit ka konkluduar se ish-arkëtari i bankës ishte proceduar dhe gjykuar për veprën penale 'Dëshmi të rreme' dhe për këtë arsye prokurori ka kërkuar të pyetet edhe ai në këtë proces. Ndërkohë që i pandehuri në ankim ka pretenduar pafajësi referuar edhe deklarimeve të këtij shtetasi, ish-arkëtarit, gjykata e pranoi këtë kërkesë të prokurorit. Mosparaqitja e arkëtarit në cilësinë e personit nën hetim, për dy seanca është vlerësuar e justifikuar për shkak të paraqitjes prej tij të kërkesës për të qenë i mbrojtur nga një avokat dhe në kushtet e paraqitjes së raportit mjekësor. Tejkalimi i afateve të gjykimit kanë ardhur si pasojë e kryerjes së veprimeve hetimore të domosdoshme të pakryera gjatë hetimit dhe gjykimit në shkallë të parë, pa të cilat nuk mund të konkludohej në lidhje me shkaqet ankimore parashtruar si nga prokuroria edhe i pandehuri, i cili kërkonte pafajësi. Hetimi gjyqësor i kryer është pranuar si nga akuza edhe nga i pandehuri. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit është paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila ka vendosur mospranim rekursi*".

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit lidhur me shkaqet e tejkalimit të afateve në gjykim dhe procesverbalet e seancave gjyqësore të kësaj çështjeje, ku subjekti ka qenë kryesuese, vlerësoi se janë bindëse, pasi në rastin konkret rezulton që gjykimi tej afatit ligjor të parashikuar është i justifikuar me kryerjen e hetimit të pjesshëm në këtë shkallë gjykimi, për veprime hetimore të domosdoshme, të cilat nuk ishin kryer në shkallë të parë, të pranuara si

---

[52]Shihni dokumentet bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 4, në dosjen e Komisionit.
[53] Shihni procesverbalet e seancave gjyqësore dërguar në rrugë elektronike në datën 4.6.2020, në dosjen e Komisionit.

nga akuza ashtu edhe nga i pandehuri. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit është paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila ka vendosur mospranim rekursi.

**2.3** Në lidhje me çështjen që i përket vendimit nr. ***, datë 11.5.2016 i Gjykatës së Apelit Gjirokastër me paditës Z.I. dhe I.I., në përgjigje të pyetësorit nr. 4, subjekti ka vënë në dispozicion vërtetimin nr. *** prot., datë 11.2.2020, të lëshuar nga kancelari i Gjykatës së Apelit Gjirokastër, sipas të cilit çështja civile është regjistruar në datën 25.4.2016 dhe ka përfunduar në datën 11.5.2016. Kohëzgjatja e gjykimit është 16 ditë. Nuk u konstatuan zvarritje në gjykim.

**3.** Pesë dosjet e shortuara me shortin e datës 21.9.2018, nga analiza e të cilave gjatë hetimit administrativ rezultuan të njëjtat gjetje si ato të evidentuara në raportin e KLD-së, për të cilat subjektit i janë kërkuar shpjegime (trajtuar më sipër).

**4.** Tri ankesa të vitit 2016 evidentuar në raportin e KLD-së, shkak i të cilave përgjithësisht ka qenë tejkalimi i afteve të gjykimit nga subjekti i rivlerësimit. Në lidhje me këto tri ankesa, gjatë hetimit administrativ, subjekti ka vënë në dispozicion shpjegime të detajuara dhe dokumente shkresore, nga shqyrtimi i të cilave në përfundim të hetimit administrativ rezultoi se:

**4.1** Në lidhje me ankesën e shtetasit I. S.

Në përgjigjet e pyetësorit nr. 4, subjekti vuri në dispozicion procesverbalet e seancave gjyqësore, të çështjes nr. ***, gjykuar nga trupi gjykues i përbërë prej T. S. (kryesues), I. B., Miranda Andoni (anëtare), si dhe faqen e regjistrit themeltar civil, sipas së cilës data e regjistrimit të çështjes është 13.10.2014**,** dhe se çështja ka zgjatur rreth 1 vit, 3 muaj e 9 ditë, pra, në tejkalim të afatit 6-mujor të gjykimit civil në Gjykatën e Apelit sipas vendimit nr. ***, datë 14.4.2020, "Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve".

Në lidhje me shkaqet e tejkalimit të afateve të gjykimit në këtë çështje, Komisioni i ka kërkuar sqarime subjektit, e cila në parashtrimet e datës 10.3.2020, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, ka deklaruar se: "*... nga përmbajtja e procesverbaleve gjyqësore, në mungesë të akteve të tjera për shkak se dosja ndodhet për gjykim në Gjykatën e Lartë konstatohet se në këtë çështje civile disa seanca gjyqësore janë shtyrë për shkak të kërkesave për përjashtim të gyqtarëve të çështjes nga palët ndërgjyqëse dhe për shkak të dorëheqjeve nga vetë gjyqtarë të caktuar për gjykim për shkak se midis palëve ka pasur disa mosmarrëveshje. Kështu, qysh në seancën e parë gjyqësore është kërkuar përjashtim gjyqtari nga pala paditëse. Më pas, është kërkuar heqje dorë nga gjykimi i kësaj çështjeje nga gjyqtar D. B., i cili sa kishte hyrë në proces, kërkesë e cila është pranuar dhe është zëvendësuar me një gjyqtar të Gjykatës së Apelit Vlorë. Nga ana e vet, edhe gjyqtari S. N. ka parashtruar dorëheqje nga gjykimi, kërkesë e cila nuk është pranuar. Më pas, po ky gjyqtar ka dhënë dorëheqje për një shkak tjetër të ndryshëm nga ai i pari. Një seancë gjyqësore është shtyrë për mosformim të trupit gjykues pasi gjyqtarin Sokol Ngresi, i cili ishte në pamundësi për të ardhur për arsye shëndetësore duke depozituar edhe raportin mjekësor. Më pas, seanca është shtyrë për shkak të lënies kohë për plotësimin e të metave në ankim nga pala ankuese (neni 455). Me plotësimin e të metave në ankim, Gjykata e Apelit, pasi dëgjoi palët prezent në lidhje me shkaqet ankimore dhe vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë ka vendosur kryerje të hetimit të pjesshëm dhe administrim provash të reja. Ndërkohë, gjatë gjykimit është paraqitur për herë të parë një nga palët dhe mbi kërkesën e saj është shtyrë një seancë me qëllim që përfaqësuesja e saj të njihej me aktet në dosje. Me cilësinë e anëtares asnjëherë nuk kam qenë pengesë në shtyrjen e seancave gjyqësore. Kjo çështje është për gjykim në Gjykatën e Lartë dhe për këtë shkak, nuk kam mundur të siguroj dokumentacion përveç procesverbalit gjyqësor".*

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit lidhur me shkaqet e tejkalimit të afateve në gjykim dhe procesverbalet e seancave gjyqësore të kësaj çështjeje, vlerësoi se janë bindëse,

pasi në rastin konkret rezulton që gjykimi tej afatit ligjor të parashikuar lidhet me: (i) kërkesat për përjashtim të gyqtarëve të çështjes nga palët ndërgjyqëse; (ii) dorëheqjet nga vetë gjyqtarët e çështjes; (iii) mosformimin e trupit gjykues; (iv) plotësimin e të metave në ankim; (v) kryerjen e hetimit të pjesshëm dhe administrimin e provave të reja; (vi) kërkesën për njohje e përfaqësues së palës me aktet në dosje.

Nga të dhënat e administruara në dosje nuk konstatohet ndonjë rast që me veprimet a mosveprimet e saj, subjekti i rivlerësimit të ketë qenë shkak për shtyrjen e seancave.

**4.2** Në lidhje me ankesën e shtetases R. Ç.

Gjatë procesit të rivlerësimit, në përgjigjet e pyetësorit nr. 4, subjekti vuri në dispozicion procesverbalet e seancave gjyqësore dhe akte të tjera të çështjes nr. *** të zhvilluara nga trupi gjykues i përbërë nga Miranda Andoni (kryesues), E. Dh. dhe I. B., si dhe faqen e regjistrit themeltar penal sipas të cilës data e regjistrimit është 10.11.2015, nga ku rezulton se kohëzgjatja e çështjes ka qenë 4 muaj e 20 ditë, pra, në tejkalim të afatit 30-ditor sipas nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale, i ndryshuar në 2017.

E pyetur gjatë procesit të rivlerësimit lidhur me arsyet e tejkalimit të afateve të shqyrtimit të kësaj çështjeje subjekti ka sqaruar se: *"Arsyet e tejkalimit të afateve të shqyrtimit të kësaj çështjeje kanë lidhje kryesisht me kërkesat që paraqiste vetë ankuesja R. Ç. Konkretisht, në seancën e parë, ankuesja R. Ç. ka kërkuar përjashtim të prokurorit të apelit, madje përjashtimin e të dy prokurorëve pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastër. Në një seancë gjyqësore ka kërkuar edhe përjashtim gjyqtari. Në kushtet që nuk është pranuar përjashtimi i prokurorit A. A., ankuesja R. Ç., ka kërkuar shtyrje për përfaqësim me avokat. Më pas, ka qenë përfaqësuesi i ankueses që ka kërkuar kohë të njihet me aktet dhe një seancë më pas ka përfunduar gjykimi i çështjes. Gjykata ishte e detyruar të vendoste shtyrjen e seancave gjyqësore pasi kërkesat e ankueses ishin të tilla që sillnin këtë pasojë, shtyrjen e gjykimit".*

Megjithëse në nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale në fuqi në vitin 2015, nuk parashikohej një afat shqyrtimi nga Gjykata e Apelit për ankimet ndaj vendimit të prokurorisë për mosfillimin e procedimit penal, Komisioni analizoi shpjegimet e subjektit bazuar në procesverbalet e seancave gjyqësore të kësaj çështjeje dhe vlerësoi se janë bindëse, pasi në rastin konkret, në çështjen me objekt: "kundërshtim vendimi të datës 7.3.2015 të Prokurorisë për mosfillimin e procedimit penal", rezulton që kjo kohëzgjatje gjykimi ka ardhur për shkak të: (i) kërkesave të përsëritura të ankueses për përjashtimin e prokurorit A. A. deri në shqyrtimin e kërkesave të saj nga Prokurori i Përgjithshëm; (ii) kërkesave për përjashtimin e gjyqtarit E. Dh.; si dhe (iii) kërkesave të avokatit të ankueses për shtyrje gjykimi.

**4.3** Në lidhje me ankesën e shtetasit L. A.

Gjatë procesit të rivlerësimit, në përgjigjet e pyetësorit nr. 4 subjekti vuri në dispozicion procesverbalet e seancave gjyqësore të çështjes nr. *** me objekt "anulim akti administrativ, pavlefshmëri kontratë shitblerjeje", nga trupi gjykues i përbërë nga I. B. (kryesuese), M. A. (anëtare) dhe T. S.i me paditës Xh. A., si dhe faqen e regjistrit themeltar civil sipas të cilës data e regjistrimit të çështjes është 18.6.2015, nga ku rezulton se kohëzgjatja e çështjes është 1 vit e një muaj, pra, në tejkalim të afatit 6-mujor për gjykimet civile në Gjykatën e Apelit.

Në lidhje me shkaqet e tejkalimit të afateve të gjykimit në këtë çështje, bazuar në procesverbalet e seancave gjyqësore, subjekti deklaroi se: **"....***shtetasi L. A. ka qenë me cilësinë e përfaqësuesit të palës paditëse, Xh. A. në çështjen civile regjistruar në datë 22.6.2015 sipas regjistrimit të Regjistrit të Veprimeve. Shtyrja e seancave gjyqësore kanë ardhur si pasojë e kërkesave për përjashtim gjyqtari, kryerja e ekspertimit, proces i cili kërkon konsumimin e një seance gjyqësore për kryerjen e betimit dhe caktimin e detyrave dhe lënien kohë për kryerje akti. Gjithashtu, për kryerjen e ekspertimit, eksperti ka pasur problem me palët të cilat nuk binin*

*dakord për të qenë njëherësh në vendin e ekspertimit. Më pas është kërkuar përjashtimi i ekspertëve, kërkesë e cila është pranuar pasi është vërtetuar se një prej ekspertëve kishte shfaqur njëherë mendim në lidhje me pronën objekt shqyrtimi në një proces tjetër me palë të tjera. Për këtë arsye është vendosur caktimi i dy ekspertëve të rinj, ndërkohë që është kërkuar informacion në lidhje me zonën e konfliktit. Është kryer betimi i ekspertëve të rinj, ndërkohë që i është kërkuar informacion Ministrisë së Bujqësisë me qëllim konkludimin për çështjen . Një prej ekspertëve ka kërkuar zëvendësimin në kushtet që ishte me probleme shëndetësore, kërkesë e cila është pranuar dhe është zëvendësuar me një ekspert nga rrethi Vlorë. Me kërkesë të ekspertit për arsye familjare edhe në kushtet që një prej palëve kishte kërkuar kryerjen mirë të aktit të ekspertimit nuk janë zhvilluar dy seanca gjyqësore. Gjithashtu, një seancë gjyqësore nuk është zhvilluar për mungesë të gjyqtarit T. S., i cili për probleme familjare ishte larguar nga ambientet e gjykatës. Kjo çështje ndodhet për gjykim në Gjykatën e Lartë dhe nuk mund të siguroja dokumentacionin justifikues të shtyrjes së seancave" .*

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit lidhur me shkaqet e tejkalimit të afateve në gjykim dhe procesverbalet e seancave gjyqësore të kësaj çështjeje, vlerësoi se janë bindëse, pasi në rastin konkret rezulton që kjo kohëzgjatje në gjykim ka ardhur për shkak të kërkesave për përjashtim gjyqtari, përjashtim eksperti, kryerja e ekspertimit, mosformim i trupit gjykues për shkak të mungesës objektive të një anëtari të trupit gjykues, si dhe shtyrje afati për kryerje aktekspertimi.

**5.** Pesëmbëdhjete denoncime nga publiku të administruara nga Komisioni, nga të cilat pasi u analizuan, rezultoi se vetëm tri prej tyre përmbushin kriteret e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, dhe për të cilat u kryen verifikime të mëtejshme, si vijojnë:

**5.1** Në denoncimin e tij, shtetasi F. Ç.[54], denoncon për zvarritje të procesit gjyqësor civil trupin gjykues të Gjykatës së Apelit Gjirokastër T. S. (relator), I. I. dhe M. A.. Denoncuesi informon se çështja e tij (pjesëtim pasurie e ndodhur në fshatin Stegopul, të cilën denoncuesi dhe vëllai i tij A. C. në cilësinë e paditësit e kanë trashëguar nga prindërit) ka nisur të shqyrtohet në Gjykatën e Apelit Gjirokastër në vitin 2013 e deri në vitin 2018.

Gjatë hetimit administrativ subjektit iu kërkuan sqarime në lidhje me kohëzgjatjen e gjykimit dhe shkaqet e kësaj zvarritjeje. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, subjekti ka sqaruar se shkak i kësaj tejzgjatjeje kanë qenë kërkesat e përsëritura të denoncuesit për përjashtimin e anëtarëve të trupit gjykues, duke argumentuar bindshëm se kjo kohëzgjatje nuk ka ardhur si pasojë e veprimeve a mosveprimeve të subjektit, përkundrazi, kërkesat e saj për dorëheqje tregojnë se në cilësinë e anëtares së trupit gjykues ka marrë të gjitha masat për të shmangur zvarritjen e procesit të rivlerësimit. Subjekti i vërtetoi pretendimet e saj me dokumentet shkresore, si vijojnë:

- dy kërkesat e dorëheqjeve të datave 25.7.2018 dhe 21.2.2019 drejtuar kryetarit të Gjykatës së Apelit Gjirokastër;

- 2 vendimet e shqyrtimit të dorëheqjeve të datave 26.7.2028 dhe 22.2.2019 të kryetarit të Gjykatës D. B., nga të cilat u konstatua se vetëm në datën 22.2.2019, është pranuar dorëheqja e subjektit të rivlerësimit nga gjykimi i kësaj çështjeje.

**5.2** Në denoncimin e saj shtetasja E. R.[55] denoncon trupin gjykues të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, të përbërë nga D. B., E. Dh. dhe Miranda Andoni, në lidhje me vendimin nr. ***, datë 12.10.2017 të marrë mbi një analizë abuzive dhe në shkelje të ligjit të pronave duke rrëzuar padinë e denoncueses. Gjithashtu, denoncuesja pretendon se ky trup ka zvarritur procesin pasi

[54] Shihni ankesën nga z. F. Ç., protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 26.12.2018 dhe denoncim protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 24.12.2018, në dosjen e Komisionit.
[55] Shihni denoncimin nga znj. E. R., protokolluar me nr. *** prot., datë 5.4.2018, në dosjen e Komisionit.

e ka marrë dosjen në muajin tetor 2016 dhe shpallja e vendimit nga kjo gjykatë është bërë në datën 12.10.2017.

Në lidhje me pretendimin mbi vendimmarrjen, referuar pikës 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", vlerësohet se nuk është në kompetencën e Komisionit të gjykojë mbi korrektësinë e vendimit dhe themelit të çështjes, tagra këto të cilat janë në kompetencë të një gjykate më të lartë. Gjithashtu, nga verifikimi në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë[56], kjo çështje është në shqyrtim me status në studim.

Në lidhje me pretendimin për zvarritje të procesit, nga përmbledhja e vendimit të publikuar në faqen e Gjykatës së Apelit Gjirokastër, rezulton se çështja është regjistruar në datën 23.10.2016 dhe vendimi është shpallur në datën 10.11.2017, pra, ka zgjatur rreth 1 vit. Bazuar në vendimin nr. ***, datë 14.4.2010 të KLD-së mbi sistemin e vlerësimit të gjyqtarëve, kohëzgjatja e gjykimit civil në Gjykatën e Apelit është 6 muaj.

Gjatë procesit të rivlerësimit, lidhur me këtë çështje, subjekti ka vënë në dispozicion procesverbalet e seancave gjyqësore dhe ka deklaruar se: "*...shtyrjet e seancave gjyqësore kanë qenë gjithmonë të justifikuara në funksion të një hetimi sa më të plotë dhe të gjithanshëm".* Ndërsa në parashtrimet e datës 10.3.2020, pas evidentimit të konstatimit edhe në rezultatet e hetimit, subjekti ka vënë në dispozicion procesverbalet e seancave gjyqësore duke sqaruar se: "*Në këtë çështje civile ku objekt i gjykimit ishte anulimi i dy vendimeve të K. K. Pronave është vlerësuar qysh në seancën e parë gjyqësore, kryerja e hetimit të pjesshëm dhe ripyetja e ekspertëve në kushtet që nga akti i ekspertimit kryer gjatë gjykimit në shkallë të parë rezultoi të mos ishin pasqyruar ndryshimet e vendimit të K. K. Pronave të palës së paditur objekt ankimimi. Nga seanca e pyetjes së ekspertëve është konkluduar se kishte nevojë për plotësim të ekspertimit duke iu ngarkuar detyra të reja shtesë nga kjo gjykatë. Në kushtet që të dy palët mbivendoseshin në një pjesë të pronave të pretenduara, me qëllim hetimin në lidhje me legjitimimin e palës paditëse, provueshmërisë së ish pronësisë mbi pronën e pretenduar ka rezultuar i domosdoshëm edhe kërkimi pranë ZAMT të të dhënave në lidhje me ish-pronësinë e trashëgimlënësit, të palës paditëse dhe konfiguracionin e pronave. Gjatë gjykimit, vetë pala paditëse përfaqësuesi i saj, ka qenë shkak për shtyrje të disa seancave gjyqësore (datë 10.1.2017 , 25.4.2017, 21.7.2017) ndërkohë që ka pasur shtyrje seance edhe nga pala tjetër, ku në një prej tyre ka qenë për shkak se përfaqësuesi i palës së paditur ka ndërruar jetë dhe është kërkuar përfaqësim i ri".*

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe procesverbalet e seancave gjyqësore, arriti në përfundimin se subjekti shpjegoi dhe argumentoi në mënyrë bindëse arsyet e kohëzgjatjes, referuar këtyre rrethanave: (i) për çështjen në fjalë bazuar në nenin 465 të Kodit të Procedurës Civile është vendosur hetim i pjesshëm, gjë që ka sjellë zgjatjen në kohë të gjykimit të çështjes; (ii) ka kërkesë për shtyrje gjykimi nga avokati; (iii) ka kryerje aktekspertimi shtesë; (iv) mosnjohja e palëve me aktin e ekspertimit; (v) ka kërkesa për shtyrje nga avokati për arsye shëndetësore (me raport); (vi) ndërrimi i jetës së njërit prej avokatëve të palës; njohje e përfaqësuesve të palëve me aktet e dosjes; (vii) përfundimi i aktekspertimit pas përgjigjeve të reja, ndërkohë që për këtë çështje janë paralajmëruar ekspertët për mosparaqitje në seancë, si dhe avokatët për marrjen e masave për moszvarritjen e procesit; si dhe (viii) paraqitja e konkluzioneve përfundimtare.

**5.3** Në denoncimin e tij, shtetasi A. K.[57]denoncon trupin gjykues të Gjykatës së Apelit Gjirokastër të përbërë nga Miranda Andoni (kryesuese), I. B. dhe T. S., që ka gjykuar çështjen

[56]http://www.gjykataelarte.gov.al/gjl_ceshtje_detaje.php?caseId_sel=201802189&ln=Lng1&uni=20200117105509134061106140528621

[57] Shihni denoncimin nga z. A. K., protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 13.12.2019, në dosjen e Komisionit.

me paditës A. Ç., palë e tretë A. K. dhe i paditur përmbaruesi gjyqësor privat "***", me objekt "kundërshtim i veprimeve përmbarimore".

Denoncuesi pretendon se ky trup ka ndryshuar datën e seancës nga data 19.5.2015, ora 14:15 në datën 12.5.2015, në orën 15:17, pa e njoftuar atë si palë, duke iu mohuar e drejta për të marrë pjesë në gjykim duke sjellë si pasojë mospasjen mundësi nga ana e tij për të paraqitur prova të tjera.

Për të vërtetuar pretendimet e tij, denoncuesi ka vënë në dispozicion: (1) kopje të procesverbalit të seancës datës 28.4.2015; (2) kopje të regjistrit elektronik; (3) kopje të procesverbalit të datës 12.5.2015, nga verifikimi i të cilave, konstatohet se gjatë seancës gjyqësore të datës 28.4.2015, trupi gjykues me kërkesë të personit të tretë A. (A.) K. ka shtyrë seancën në datën 19.5.2015, ora 14:15. Ndërkohë, seanca tjetër nuk është zhvilluar në këtë datë, por në datën 12.5.2015, ora 15:18, seancë në të cilën palët ndërgjyqëse nuk kanë qenë prezent, pasi sipas denoncuesit nuk kishin marrë dijeni. Ndërsa, nga përmbajtja e procesverbalit të seancës së datës 12.5.2015, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e kryesueses, është shprehur se palët janë njoftuar.

Në lidhje me sa u konstatua, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime, e cila në parashtrimet e datës 10.3.2020 ka sqaruar se: "*Seanca e parë gjyqësore është planifikuar dhe është zhvilluar në datën 28.4.2015 seancë në të cilën, është paraqitur vetëm personi i tretë, A. K., i cili ka kërkuar shtyrjen e seancës gjyqësore për një ditë tjetër, për shkak se përfaqësuesja e tij, për arsye objektive (rast vdekje) nuk mund të ishte e pranishme. Kjo kërkesë është pranuar nga gjykata dhe është vendosur që seanca e radhës të zhvillohej në datën 19.5.2015. Për shkak të një gabimi njerëzor (në kushtet e një dite të ngarkuar gjyqësore), seanca gjyqësore është zhvilluar në datën 12.5.2015 dhe jo në datën 19.5.2015. Personi i tretë nuk kishte dijeni rregullisht për seancën gjyqësore të datës 12.5.2015, pasi njoftimi është marrë nga pala në seancën e mëparshme për datën 19.5.2019. Relatimi nga ana ime, me cilësinë e relatores, se personi i tretë kishte dijeni për seancën e datës 12.5.2015, është kryer referuar faktit që personi i tretë, kishte qenë i pranishëm në seancën e mëparshme gjyqësore, por, pa u vënë re mospërputhja e datës së seancës që po zhvillohej gjykimi me datën që kishte marrë dijeni personi i tretë. Në këto rrethana, në aktet në dosje nuk ka njoftim për seancën e datës 12.5.2015. Kjo ka ndodhur në kushtet e një dite të ngarkuar me procese gjyqësore që zhvilloheshin njëra pas tjetrës dhe çështja në fjalë është zhvilluar pas orës 15:00".*

Pavarësisht pretendimeve të subjektit, në kushtet kur zhvillimi i seancës dëgjimore është kryer pa marrë dijeni pala kërkuese (denoncuesi), Komisioni çmoi se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 4 të Kodit të Procedurës Civile sipas të cilit: "*Gjykata kujdeset për zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor. Për këtë qëllim, në bazë të kompetencave që i jepen nga ky Kod, vendos për afatet dhe urdhëron marrjen e masave të nevojshme.*"

**Qëndrimi i Komisionit në lidhje me rivlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.**

Për sa i takon çështjeve për të cilat u evidentuan tejkalime të afateve të gjykimit, analizuar në mënyrë specifike si më sipër në këtë vendim, Komisioni iu referua vendimit nr. 69, datë 17.11.2015 dhe vendimit nr.1, datë 21.1.2016 të Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilëve "*kohëzgjatja e arsyeshme e procesit gjyqësor, duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes, duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkuesit, dhe autoriteteve përkatëse"*, dhe në përfundim, krijoi bindjen se zgjatja e afateve ne çdo rast, nuk ka qenë për faj apo neglizhencë të subjektit të rivlerësimit, por ka ndodhur për shkaqe të përligjura. Në asnjë rast subjekti i rivlerësimit nuk është bërë shkak me veprimet apo mosveprimet e saj për tejkalimet e afateve të gjykimit, por ato kanë ardhur për shkaqe të pavarura prej saj, si dhe për shkak të kompleksitetit të çështjeve, rrethanë e cila vlerësohet

proporcionalisht në raport edhe me treguesit e tjerë brenda kriterit të aftësive organizative, sikurse rendimenti (vjetor) e ngarkesa në punë[58].

Për sa i takon mangësive për të cilat subjekti ka dhënë shpjegime specifikisht për çdo rast, në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni vlerësoi se parregullsitë në rastet e evidentuara nuk tregojnë që subjekti ka njohuri, aftësi në gjykim, qëndrime ose modele pune të dobëta, të tilla sa të kenë rrezikuar dhe cënuar të drejtat e qytetarëve, apo ato të jenë bërë pengesë në mbarëvajtjen e proceseve, ndërkohë që, për këtë subjekt rivlerësimi nuk ka pasur të dhëna të cilido lloj burimi që me veprimet ose mosveprimet e saj të ketë ndikuar në mbarëvajtjen e proceseve gjyqësore. (pika 5, neni E e Aneksit të Kushtetutës).

Për sa i takon çështjes civile nr. *** akti me palë ndërgjyqëse: paditës A. C., e paditur Zyra Përmbarimore "***" sh.p.k., person i tretë A. (A.) K., e gjykuar në Gjykatën e Apelit Gjirokastër me vendimin nr. ***, datë 12.5.2015, denoncuar prej shtetasit A. K., në përfundim Komisioni vlerësoi se me zhvillimin e seancës gjyqësore në datën 12.5.2015, pa dijeninë e personit të tretë, nuk është përmbushur nga subjekti detyrimi ligjor parashikuar nga neni 4 i Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit gjykata duhet të marrë masat për një proces të rregullt ligjor. Por, në vlerësimin e peshës specifike të kësaj çështjeje në qëndrimin përfundimtar, Komisioni ka mbajtur në konsideratë edhe faktin që denoncuesi në denoncimin e tij nuk ka paraqitur asnjë fakt e provë lidhur me pasojën që ka ardhur nga mosmarrja pjesë në seancën gjyqësore të datës 12.5.2015, ndërkohë që çështja është për gjykim në Gjykatën e Lartë[59] me status "studim i çështjes".

Gjithashtu, Komisioni, duke mbajtur në konsideratë se kjo ka qenë e vetmja çështje ku janë evidentuar shkelje procedurale të kësaj natyre, i është referuar vendimit nr. 2 /2017 të Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilit: *"Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale".* Për rrjedhojë, nuk e çmoi këtë rast si shkak për vlerësim negativ të aftësive profesionale të znj. Miranda Andoni, por çmoi ta transferojë këtë çështje pranë organit kompetent për inspektim për shkaqet e analizuara më lart.

Bazuar në sa më sipër, Komisioni, pasi shqyrtoi kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas përcaktimit të nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, vlerëson se subjekti i rivlerësimit: a) ka aftësi për të gjykuar; b) ka aftësi të pranueshme organizative, per shkak se mangësite e evidentuara nuk kanë rezultuar në mosrespektim të të drejtave të palëve apo mungesë jo të pranueshme eficence ose efektiviteti; c) e ka zhvilluar veprimtarinë gjyqësore në përputhje me etikën dhe angazhimin ndaj vlerave gjyqësore; dhe ç) ka demonstruar cilësi personale dhe angazhim profesional, në përputhje me standardet e parashikuara në ligj.

Në përfundim të rivlerësimit profesional, të kryer sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, referuar neneve 72, 74, 75, 76 dhe 77 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", pas propozimit të relatores, Komisioni vlerësoi që subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, ka arritur nivelin minimal kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës "c", të pikës 1, të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, duke u konsideruar "E aftë".

---

[58] Shih vendimin e KPA Nr.21 datë 13.09.2019.

[59] http://www.gjykataelarte.gov.al/gjl_ceshtje_detaje.php?caseId_sel=201505601&ln=Lng1&uni=20200624141925134061106272343079.

## III. SEANCA DËGJIMORE

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 9.6.2020, në sallën e konferencave, në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier.

Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin e saj, duke parashtruar shpjegime dhe opinione lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke kërkuar konfirmimin në detyrë.

Në datën 12.6.2020 u zhvillua seanca në të cilën Komisioni shpalli vendimin për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Miranda Andoni.

## IV. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Znj. Miranda Andoni, gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, ka qenë plotësisht bashkëpunuese, duke u përgjigjur në çdo rast brenda afateve të caktuara nga Komisioni dhe duke dhënë përgjigje shteruese. Gjithashtu, Komisioni vlerësoi qëndrimin objektiv dhe reflektues të subjektit në lidhje me pasaktësitë e konstatuara ne vleresimin e pasurise si dhe mangësive të evidentuara gjatë vleresimit të aftësive profesionale, si gjatë procesit të rivlerësimit, ashtu dhe në parashtrimet e saj, pasi u njoh me rezultatet e hetimit administrativ.

## V. KONKUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara dhe rekomandimet e relatores së çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

**PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u mblodh në dhomë këshillimi në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar sipas parashikimit të pikës 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, bazuar në nenin 58, pika 1, germa "a", të nenit 59, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë",

**V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Miranda Andoni, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastër.

2. Transferimin e çështjes civile nr. ***Akti, me palë ndërgjyqëse: paditës A. Ç., e paditur Zyra Përmbarimore "***" sh.p.k., person i tretë A. (A.) K. të gjykuar në Gjykatën e Apelit Gjirokastër me vendimin nr. ***, datë 12.5.2015, pranë organit kompetent për inspektim të shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore sipas pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

3. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

4. Ky vendim, me përjashtim të pikës 2, mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
5. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 12.06.2020.

**ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Pamela QIRKO**
**Kryesuese**

**Firdes SHULI**
**Relatore**

**Olsi KOMICI**
**Anëtar**

*Sekretare gjyqësore*
*Anisa Duka*